



Federata Shqiptare e Futbollit

# KODI I DISIPLINËS SPORTIVE

Botim zyrtar, 2019

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretar i Përgjithshëm:

Ilir SHULKU

Themeluar: 1930

Anëtare e UEFA-s: 1954

Anëtare e FIFA-s: 1930

---

Realizoi botimin: “Reklama”

# PËRMBAJTJA

<b>TITULLI I</b>	<b>HYRJE</b> .....	9
Neni 1	Objekti .....	9
Neni 2	Qëllimi i zbatimit: rregulli themelor .....	9
Neni 3	Qëllimi i zbatimit: individët dhe personat juridikë .....	9
Neni 4	Zbatimi i kodit në kohë .....	10
Neni 5	Përcaktimet .....	10
Neni 6	Gjinia dhe numri .....	11
<b>TITULLI II</b>	<b>RREGULLAT THEMELORE</b> .....	12
<i>Kreu I</i>	<i>Pjesa e Përgjithshme</i> .....	12
<b>SEKSIONI 1.</b>	<b>Kushtet për dënime</b> .....	12
Neni 7	Fajësia.....	12
Neni 8	Aktet e mbetura në tentativë .....	12
Neni 9	Pjesëmarrja .....	12
<b>SEKSIONI 2:</b>	<b>Dënime të ndryshme</b> .....	13
Neni 10	Masat Disiplinore .....	13
Neni 11	Dënime për individët .....	14
Neni 12	Paralajmërimi .....	14
Neni 13	Qortimi .....	15
Neni 14	Gjoha .....	15
Neni 15	Zmbrapsje e trofeve .....	15
Neni 16	Masë ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) ..	15

Neni 17	Masë ndëshkimore largimi nga ndeshja (karton i kuq) ...	16
Neni 18	Pezullimi nga ndeshja .....	17
Neni 19	Ndalim ose dëbim nga dhomat e zhveshjes ose nga stoli i rezervave .....	18
Neni 20	Ndalim i hyrjes në stadium .....	18
Neni 21	Ndalim i pjesëmarrjes në ndonjë veprimtari futbolistike ....	18
Neni 22	Ndalim i kryerjes së transferimit ose federimit të lojtarëve...	18
Neni 23	Zhvillim i ndeshjes pa spektatorë .....	18
Neni 24	Zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjane .....	19
Neni 25	Ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar.....	19
Neni 26	Anullimi i rezultatit të një ndeshje .....	19
Neni 27	Përjashtimi nga një garë ose kampionat .....	19
Neni 28	Zbritje në një kategori më të ulët .....	19
Neni 29	Zbritje e pikëve në klasifikim .....	20
Neni 30	Humbja e ndeshjes në tavolinë .....	20
<b>SEKSIONI 3.</b>	<b>Përcaktime të përgjithshme .....</b>	<b>21</b>
Neni 31	Dënimet e kombinuara .....	21
Neni 32	Pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimeve .....	21
Neni 33	Dënimet kohore: përlllogaritja e periudhës .....	22
Neni 34	Centralizimi i dënimeve .....	22
<b>SEKSIONI 4.</b>	<b>Mbartja dhe anulimi i masave ndëshkimore (kartonat) dhe pezullimi nga ndeshja .....</b>	<b>22</b>
Neni 35	Mbartja e masave ndëshkimore .....	22
Neni 36	Anullimi i masave ndëshkimore .....	23
Neni 37	Mbartja e pezullimit nga ndeshja .....	23
<b>SEKSIONI 5.</b>	<b>Përlllogaritja e dënimit .....</b>	<b>24</b>
Neni 38	Rregulli i përgjithshëm .....	24
Neni 39	Shkeljet e përsëritura .....	24
Neni 40	Shkeljet e njëkohshme .....	24

<b>SEKSIONI 6.</b>	Parashkrimi .....	24
	Neni 41 Parashkrimi për gjykim .....	24
	Neni 42 Fillimi i periudhës së parashkrimit .....	25
	Neni 43 Ndërprerja e periudhës së parashkrimit .....	25
	Neni 44 Periudha e parashkrimit për zbatimin e dënimeve .....	25
<b>PJESA E POSAÇME</b>	.....	26
<b>SEKSIONI 7.</b>	Shkeljet e Ligjeve të Lojës .....	26
	Neni 45 Shkeljet e lehta .....	26
	Neni 46 Shkeljet e rënda .....	26
<b>SEKSIONI 8.</b>	Rrëmuajt gjatë ndeshjeve ose garave .....	27
	Neni 47 Sjellja e keqe ndaj kundërshtarëve dhe çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes .....	27
	Neni 48 Sjellja e keqe ndaj zyrtarëve të ndeshjes .....	29
	Neni 49 Grindja .....	30
	Neni 50 Agresorët e paidentifikuar .....	30
<b>SEKSIONI 9.</b>	Sjellja e ekipeve .....	30
	Neni 51 Nxitja e urrejtjes dhe akteve të dhunës .....	30
	Neni 52 Provokimi i publikut .....	31
	Neni 53 E drejta për të luajtur .....	31
	Neni 54 Braktisja .....	31
<b>SEKSIONI 10.</b>	Sjelljet ofenduese dhe diskriminuese .....	32
	Neni 55 Sjellja ofenduese dhe fair play .....	32
	Neni 56 Diskriminimi .....	32
<b>SEKSIONI 11.</b>	Cënimi i lirisë personale .....	33
	Neni 57 Kërcënimet .....	33
	Neni 58 Shtrëngimi .....	33
<b>SEKSIONI 12.</b>	Mashtrimi dhe falsifikimi .....	34
	Neni 59 Dokumentacioni .....	34

<b>SEKSIONI 13.</b> Korrupsioni .....	34
Neni 60 Korrupsioni .....	34
<b>SEKSIONI 14.</b> Dopingu .....	35
Neni 61 Përkufizimi dhe rregullat .....	35
<b>SEKSIONI 15.</b> Dështimi në respektimin e vendimeve .....	35
Neni 62 Vendimet dhe pagesat .....	35
<b>SEKSIONI 16.</b> Përgjegjësitë e personave juridikë, shoqatave dhe klubeve....	37
Neni 63 Organizimi i ndeshjeve .....	37
Neni 64 Dështimi në përmbushjen e përgjegjësiave .....	37
Neni 65 Përgjegjësia për sjelljen e spektatorëve .....	39
Neni 66 Detyrime të tjera .....	41
<b>SEKSIONI 17.</b> Influencimi në mënyrë të paligjshme	
i rezultatit të ndeshjes .....	42
Neni 67 Trukimi i ndeshjeve .....	42
<b>TITULLI III ORGANIZIMI DHE PROCEDURAT .....</b>	<b>43</b>
<b>Kreu I Organizimi .....</b>	<b>43</b>
<b>SEKSIONI 1.</b> Juridiksioni i FSHF-së .....	43
Neni 68 Rregulli i përgjithshëm .....	43
Neni 69 Ndeshjet miqësore midis përfaqësueseve .....	43
<b>SEKSIONI 2.</b> Autoritetet .....	44
Neni 70 Organet disiplinore .....	44
Neni 71 Komisioni i Disiplinës .....	44
Neni 72 Komisioni i Apelit .....	45
Neni 73 Inspektorët e disiplinës .....	46
Neni 74 Pavarësia .....	47
Neni 75 Përjashtimi i një anëtarë nga procedurat .....	48
Neni 76 Vendimmarrja e shumicës .....	48
Neni 77 Sekretariati i Komisioneve .....	48

Neni 78	Përgjegjësitë .....	49
<b>SEKSIONI 3:</b>	<b>Dispozita të përbashkëta për procedurat para</b>	
	organeve disiplinore .....	49
Neni 79	Palët dhe ndërhyrësit .....	49
Neni 80	Përfaqësimi .....	50
Neni 81	Ndihma juridike .....	50
Neni 82	Gjuhët .....	50
Neni 83	Mbledhjet, të drejtat e palëve, seancat, vendimet, komunikimet dhe konfidencialiteti. ....	51
Neni 84	Afatet .....	52
Neni 85	Ndëshkimet e sjelljes jo të rregullt .....	53
Neni 86	Format e provës .....	53
Neni 87	Raportet zyrtare .....	53
Neni 88	Dëshmitarët .....	54
Neni 89	Dëshmitarët anonimë .....	54
Neni 90	Identifikimi i dëshmitarëve anonim .....	55
Neni 91	Masat e përkohshme .....	56
Neni 92	Apeli i vendimeve për çështjet paraprake .....	56
Neni 93	Shpenzimet proceduriale .....	56
Neni 94	Vendimet .....	57
Neni 95	Rihapja e procedurave .....	58
Neni 96	Gjykata e Arbitrazhit të Sportit .....	58
<b>Kreu II – Procedurat para Komisionit të Disiplinës</b>	.....	59
Neni 97	Hapja e procedurave .....	59
Neni 98	Deklaratat e protestës/ankesës .....	59
Neni 99	Pranimi i deklaratave të protestës/ankesave .....	60
Neni 100	Sqarimi i fakteve .....	60
Neni 101	Forma e procedurave .....	61

<b>SEKSIONI 4:</b>	Procedurat para Komisionit të Apelit .....	61
Neni 102	Apelet, afatet dhe tarifat .....	61
Neni 103	Pranimi i Ankimeve .....	62
Neni 104	Pezullimi i ekzekutimit .....	62
Neni 105	Përgjigja ndaj Ankimit .....	62
Neni 106	Seancat dëgjimore .....	63
Neni 107	Shqyrtimet dhe vendimet .....	63
<b>KREU III</b>	.....	64
Neni 108	Rishikimi i Vendimeve .....	64
<b>TITULLI IV DISPOZITA TË VEÇANTA</b>	.....	65
<b>SEKSIONI 1.</b>	Zbatimi/Ekzekutimi .....	65
Neni 109	Kompetenca .....	65
Neni 110	Dëbimi dhe vërejtjet e grumbulluara .....	65
Neni 111	Zbatueshmëria .....	66
Neni 112	Zbatimi i jashtëzakonshëm i pezullimeve .....	66
Neni 113	Afatet kohore për ekzekutimin e vendimeve .....	67
<b>TITULLI V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE</b>	.....	68
Neni 114	Qëllimi i kodit, mangësitë, dhe precedentët .....	68
Neni 115	Konvertimi i dënimeve .....	68
Neni 116	Reduktimi i dënimeve me gjobë .....	69
Neni 117	Zbatimi i kodit .....	70



## TITULLI I HYRJE

Në mbështetje të Nenit 34 të Statutit, dhe Nenit 145, pika 2, 3 të Kodit të Disiplinës së FIFA-s, Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Futbollit miraton këtë Kod të Disiplinës Sportive (më poshtë “Kodi”).

---

### Neni 1 Objekti

---

1. Kodi përshkruan shkeljet e përkufizimeve të rregulloreve të FSHF-së, përcakton dënimet që ndërmerren, rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve përgjegjëse për marrjen e vendimeve si dhe rregullon procedurat që ndiqen pranë këtyre organeve.

---

### Neni 2 Qëllimi i zbatimit: rregulli themelor

---

1. Ky Kod zbatohet për çdo ndeshje dhe garë të organizuar nga FSHF. Përtej këtij qëllimi, ky Kod zbatohet në rastet kur çenohet një zyrtar i ndeshjes, si dhe në përgjithësi, kur shkelen objektivat themelore të FSHF-së, sidomos në lidhje me falsifikimin, korrupsionin dhe dopingun. Gjithashtu zbatohet për çdo rast kur shkelen rregulloret e FSHF-së të cilat nuk janë nën juridiksionin e ndonjë organi tjetër.

---

### Neni 3 Qëllimi i zbatimit: individët dhe personat juridikë

---

1. Janë subjekt i këtij kodi sa vijon:
  - a. të gjitha shoqatat apo personat juridik të anëtarësuar në FSHF dhe zyrtarët e tyre (dmth. të gjithë personat e caktuar nga një anëtar për të ushtruar një funksion të caktuar);

- b. të gjithë klubet pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara nga FSHF dhe zyrtarët e tyre (dmth. të gjithë personat e caktuar nga një klub për të ushtruar një funksion të caktuar);
  - c. të gjithë zyrtarët e ndeshjes;
  - d. të gjithë lojtarët;
  - e. të gjithë personat e zgjedhur, miratuar ose caktuar nga FSHF për të ushtruar një funksion të caktuar.
2. Subjektet dhe individët e mësipërm i nënshtrohen kompetencave disiplinore të FSHF-së. Ata janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së, si dhe Ligjet e Lojës të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Shoqatës së Futbollit (IFAB).

---

#### **Neni 4 Zbatimi i kodit në kohë**

---

1. Këto rregulla zbatohen mbi të gjithë subjektet nën veprimin e kodit sipas Nenit 3, në ditën kur është kryer shkelja disiplinore e pretenduar.
2. Procesi disiplinor i nisur kundër një subjekti që ka qenë nën veprimin e këtij kodi sipas Nenit 3, në ditën e kryerjes së shkeljes disiplinore të pretenduar, duhet të vazhdojë nga organet disiplinore të FSHF-së edhe pasi subjekti në fjalë nuk është më ndër subjektet nën veprimin e këtij kodi.

---

#### **Neni 5 Përcaktimet**

---

1. *Pas ndeshjes* - është koha ndërmjet fishkëllimës finale të arbitrit dhe largimit të ekipeve jashtë rrethimit të stadiumit.
2. *Para ndeshjes* - është koha ndërmjet arritjes së ekipeve në rrethimin e stadiumit dhe fishkëllimës së arbitrit për fillimin e ndeshjes.

3. *Ndeshje miqësore* - është ajo ndeshje e organizuar nga FSHF, ndonjë klub apo person midis ekipeve të ndryshme të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme, dhe rezultati ka efekt vetëm për këtë ndeshje apo turne.
4. *Ndeshje zyrtare* - është ajo ndeshje e organizuar nën mbikëqyrjen e FSHF-së, dhe rezultati ka efekt në garat dhe kampionatet e organizuara nga FSHF.
5. *Zyrtar* - është çdokush, duke përfshirë lojtarët, të cilët kryejnë veprimtari për llogari të ndonjë klubi apo për llogari të FSHF-së, pavarësisht pozicionit të punës, dhe llojit të veprimtarisë që kryen (administrative, sportive, apo ndonjë lloj tjetër) si dhe kohëzgjatjes së veprimtarisë; veçanërisht, menaxherët, trajnerët, dhe personeli mbështetës janë zyrtarë.
6. *Zyrtar ndeshje* - është arbitri, ndihmësat e arbitrit, arbitri i katërt, delegati i ndeshjes, vëzhguesi i arbitrave, personi përgjegjës për sigurinë, dhe çdo person tjetër i cili është caktuar nga FSHF dhe kanë përgjegjësi në lidhje me ndonjë ndeshje.
7. *Rregulloret e FSHF* - janë statuti, rregulloret, udhëzimet dhe qarkoret e FSHF-së, si dhe Ligjet e Lojës të lëshuara nga Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Futbollit.

---

## **Neni 6 Gjinia dhe numri**

---

1. Përcaktimet të cilat i referohen individëve janë të zbatueshme për të dyja gjinitë. Çdo përcaktim në numrin njëjës zbatohet edhe në numrin shumës, dhe anasjelltas.

## TITULLI II RREGULLAT THEMELORE

### Kreu I Pjesa e Përgjithshme

#### SEKSIONI 1

Kushtet për dënime

---

#### Neni 7 Fajësia

---

1. Duke përjashtuar rastet kur parashikohet ndryshe, shkeljet janë të dënueshme pavarësisht se janë kryer në mënyrë të vullnetshme apo nga neglizhenca.
2. Në mënyrë të veçantë, një ndeshje mund të luhet pa spektatorë apo të luhet në një fushë asnjane, ose një stadium mund të pezullohet thjesht për arsye sigurie, pa ndodhur ndonjë shkelje.

---

#### Neni 8 Aktet e mbetura në tentativë

---

1. Aktet e mbetura në tentativë janë të dënueshme.
2. Në rastin e akteve të mbetura në tentativë, organi gjykues mund të vendosë dënimin më të ulët të parashikuar në këtë kod, për aktin e mbetur në tentativë njësoj sikur të kishte ndodhur.

---

#### Neni 9 Pjesëmarrja

---

1. Kushdo që qëllimisht merr pjesë në kryerjen e ndonjë shkelje, si nxitës ose si bashkëpunëtor, është i dënueshëm.

2. Në rastin e pjesëmarrjes si nxitës ose bashkëpunëtor, organi gjykues mund të vendosë dënimin më të ulët të parashikuar në këtë kod, për shkeljen përkatëse të kryer.

## SEKSIONI 2.

Dënime të ndryshme

### Neni 10 Masat Disiplinore

1. Masat e mëposhtme disiplinore zbatohen ndaj personave juridik nën veprimin e këtij kodi:
  - a. paralajmërim;
  - b. qortim;
  - c. gjobë;
  - d. ndalimin e shitjes së biletave për mbështetësit në rastet e ndeshjeve që zhvillohen jashtë;
  - e. anulimi i rezultatit të ndeshjes;
  - f. urdhër për ri-luajtjen e ndeshjes;
  - g. zbritja e pikëve (për aktivitetet aktuale dhe/ose të ardhshme);
  - h. urdhër që ndeshja të konsiderohet e humbur;
  - i. zhvillimi i ndeshjes me dyer të mbyllura;
  - j. mbyllje e pjesshme ose e plotë e stadiumit;
  - k. zhvillimi i një ndeshjeje në një fushë asnjëse;
  - l. mbajtjen e të ardhurave nga aktivitetet e FSHF-së dhe/ose UEFA-s;
  - m. ndalimi i regjistrimit të lojtarëve të rinj në aktivitetet e FSHF-së;
  - n. kufizimi i numrit të lojtarëve që mund të regjistrojë një klub për të marrë pjesë në aktivitetet e FSHF-së;

- o. skualifikimi nga aktivitetet që janë në zhvillim dhe/ose përjashtimi nga aktivitetet e ardhshme;
- p. heqja e një titulli ose çmimi;
- q. heqja e një licence;
- r. shërbimi i futbollit në komunitet.

---

### **Neni 11 Dënime për individët**

---

1. Masat e mëposhtme disiplinore zbatohen ndaj individëve nën veprimin e këtij kodi:
  - a. paralajmërim;
  - b. qortim;
  - c. gjobë;
  - d. pezullimi nga një numër i caktuar ndeshjesh ose për një periudhë të caktuar kohe;
  - e. pezullimi nga kryerja e një funksioni brenda kuadrit të organizimit të një anëtari ose pjesëmarrësi në aktivitete ose brenda kuadrit të aktivitetit të FSHF-së, për një numër të caktuar ndeshjesh ose për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe;
  - f. ndalimin për të marrë pjesë në çdo aktivitet që lidhet me futbollin;
  - g. ndalimi i hyrjes në stadium;
  - h. ndalim ose dëbim nga dhomat e zhveshjes ose stoli i rezervave
  - i. heqja e një titulli ose çmimi;
  - j. shërbimi i futbollit në komunitet.

---

### **Neni 12 Paralajmërimi**

---

1. Paralajmërimi është një kujtesë mbi thelbin e një përcaktimi disiplinor e shoqëruar me kërcënimin se në rast të përsëritjes së shkeljes përkatëse do të ndërmerren dënime.

---

**Neni 13 Qortimi**

---

1. Qortimi është një deklaratë dënimi e shkruar, e cila i dërgohet shkelësit në lidhje me shkeljen të cilën ai ka kryer.

---

**Neni 14 Gjoba**

---

1. Një gjobë mund të vendoset në monedhën Lekë Shqiptar (me poshtë: Lekë). Gjobat duhet të paguhen vetëm në Lekë.
2. Kur nuk parashikohet në këtë kod, organi gjykues vendos për mënyrën dhe afatin e kryerjes së pagesës së gjobave të vendosura.
3. Personat juridikë, klubet ose shoqatat janë përgjegjës në mënyrë solidare ndaj gjobave të vendosura ndaj zyrtarëve ose lojtarëve të tyre. Fakti që një individ është larguar nga personi juridik, nga klubi ose nga shoqata nuk shuan përgjegjësinë solidare për shlyerjen e gjobës.
4. Gjobat nuk duhet të jenë më pak se 10.000 (dhjetëmijë) Lekë dhe më shumë se 10.000,000 (dhjetëmilionë) Lekë. Në rastin e individëve, gjoba nuk mund të tejkalojë 1.000,000 (njëmilion) Lekë.

---

**Neni 15 Zmbrapsje e trofeve**

---

1. Personi të cilit i kërkohet ose i urdhërohet kthimi i trofeve, duhet të kthejë mbrapsht të gjitha përfitimet e marra, veçanërisht shumat e parave të përfituara, si dhe objektet simbolike (medalje, kupa, etj.).

---

**Neni 16 Masë ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë)**

---

1. Masa ndëshkimore paralajmëruese (kartoni i verdhë) është një paralajmërim që arbitri i bën një lojtari gjatë ndeshjes për të dënuar sjellje jospportive të një natyre jo të rëndë (në përputhje me Ligjet e Lojës).

2. Marrja e dy masave ndëshkimore gjatë të njëjtës ndeshje pason me masë ndëshkimore largimi nga ndeshja (karton i kuq jo i drejtpërdrejtë) dhe, si pasojë, pezullimin automatik nga pjesëmarrja në ndeshjen pasuese të të njëjtës garë ose kampionat të organizuar nga FSHF. Dy masat ndëshkimore paralajmëruese të cilat pasuan me masën ndëshkimore të largimit nga ndeshja shfuqizohen.
3. Nëse një lojtar merr 3 (tre) masa ndëshkimore para-lajmëruese në dy ndeshje të ndryshme të të njëjtës garë ose kampionat të organizuar nga FSHF, ky lojtar është i pezulluar automatikisht nga pjesëmarrja në ndeshjen pasuese të asaj gare ose kampionati.
4. Nëse një ndeshje e braktisur ose e ndërprerë do të zhvillohet përsëri, atëherë çdo masë ndëshkimore paralajmëruese e lëshuar gjatë kësaj ndeshje do të anulohet. Nëse ndeshja nuk do të zhvillohet përsëri, masat ndëshkimore paralajmëruese të marra nga ekipi i cili ka shkaktuar braktisjen ose ndërprerjen e ndeshjes, do të qëndrojnë në fuqi; nëse të dy ekipet janë shkaktarë për braktisjen ose ndërprerjen e ndeshjes, atëherë të gjitha masat ndëshkimore do të qëndrojnë në fuqi.
5. Nëse një lojtar është shkaktar për një sjellje jospportive të rëndë siç përcaktohet në Ligjin 12, në Ligjet e Lojës dhe arbitri e largon nga ndeshja (me karton të kuq të drejtpërdrejtë), çdo masë ndëshkimore paralajmëruese që lojtari ka marrë më parë gjatë të njëjtës ndeshje do të qëndrojë në fuqi.

---

#### **Neni 17 Masë ndëshkimore largimi nga ndeshja (karton i kuq)**

---

1. Masa ndëshkimore e largimit nga ndeshja (kartoni i kuq) është urdhri që arbitri i jep një individ gjatë ndeshjes për t'u larguar nga ndeshja, përfshirë edhe largimin nga stoli i rezervave.



2. Masa ndëshkimore e largimit nga ndeshja merr formën e paraqitjes së kartonit të kuq. Kartoni i kuq konsiderohet i drejtpërdrejtë nëse dënohet një sjellje e rëndë josportive siç përcaktohet në Ligjin 12, në Ligjet e Lojës; dhe konsiderohet jo i drejtpërdrejtë nëse është rezultat i akumulimit të dy masave ndëshkimore paralajmëruese gjatë të njëjtës ndeshje.
3. Masa ndëshkimore e largimit nga ndeshja pason me pezullimin nga ndeshja pasuese, edhe nëse ndeshja gjatë të cilës është dhënë masa përkatëse, është braktisur ose është ndërprerë më pas. Komisioni i Disiplinës mund të zgjasë periudhën e pezullimit.

---

### **Neni 18 Pezullimi nga ndeshja**

---

1. Pezullimi nga një ndeshje është një ndalim i pjesëmarrjes në një ndeshje të ardhshme apo në një garë ose kampionat si dhe ndalim i qëndrimit në territorin përreth fushës së lojës.
2. Pezullimi vendoset i shprehur në numër ndeshjesh, ditësh, ose muajsh. Nëse nuk është e përcaktuar në dënimin e shkeljes përkatëse, pezullimi nuk mund të tejkalojë më shumë se 24 (njëzet e katër) ndeshje, ose 24 (njëzet e katër) muaj.
3. Nëse pezullimi do të kryhet i shprehur në numër ndeshjesh, atëherë do të numërohen vetëm ndeshjet e zhvilluara. Nëse një ndeshje është braktisur, ose ndërprerë, ose e përfunduar në tavolinë, pezullimi do të konsiderohet i kryer (numëruar me një ndeshje) vetëm nëse ekipi i lojtarit i cili është ndëshkuar me pezullim, nuk rezulton shkaktar për braktisjen, ndërprerjen apo përfundimin në tavolinë të ndeshjes.
4. Nëse pezullimi është i kombinuar me një gjobë, atëherë pezullimi mund të zgjatet dhe të qëndrojë në fuqi deri kur të paguhet plotësisht vlera e gjobës përkatëse.

---

**Neni 19 Ndalim ose dëbim nga dhomat e zhveshjes ose nga stoli i rezervave**

---

1. Ndalimi ose dëbimi nga dhomat e zhveshjes ose nga stoli i rezervave i heq të drejtën një individ për të hyrë në dhomat e zhveshjes si dhe për të qëndruar në territorin përreth fushës së lojës, veçanërisht i ndalohet qëndrimi në stolin e rezervave.

---

**Neni 20 Ndalim i hyrjes në stadium**

---

1. Ndalimi i hyrjes në stadium detyron një individ për të mos hyrë në një ose disa stadione.

---

**Neni 21 Ndalim i pjesëmarrjes në ndonjë veprimtari futbolistike**

---

1. Një individ mund të ndalohet të marrë pjesë në ndonjë veprimtari futbolistike (administrative, sportive, apo tjetër).

---

**Neni 22 Ndalim i kryerjes së transferimit ose federimit të lojtarëve**

---

1. Një klub mund të ndalohet të kryejë regjistrim, federim ose transferim të lojtarëve gjatë periudhës që merret masa e ndalimit të kryerjes së transferimit ose federimit të lojtarëve.

---

**Neni 23 Zhvillim i ndeshjes pa spektatorë**

---

1. Detyrimi për të luajtur një ndeshje me dyer të mbyllura i kërkon një personi juridik, një shoqate ose një klubi për të zhvilluar një ndeshje të caktuar pa spektatorë.

---

**Neni 24 Zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjane**

---

1. Një person juridik, klub apo shoqatë i dënuar të luajë një ndeshje në fushë asnjane mund ta bëjë këtë vetëm në një fushë që ndodhet të paktën 50 km larg fushës ku ai zhvillon rregullisht ndeshjet në kuadër të veprimtarive të FSHF dhe me miratim të kësaj të fundit.

---

**Neni 25 Ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar**

---

1. Ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar i heq të drejtën një personi juridik, një shoqate ose një klubi për të luajtur në një stadium të caktuar.

---

**Neni 26 Anullimi i rezultatit të një ndeshje**

---

1. Rezultati i një ndeshje anulohet nëse rezultati i arritur në fushë nuk merret në konsideratë.

---

**Neni 27 Përjashtimi nga një garë ose kampionat**

---

1. Përjashtimi është heqja e të drejtës një personi juridik, një shoqate ose një klubi për të marrë pjesë në një garë ose kampionat aktual ose të ardhshëm.

---

**Neni 28 Zbritje në një kategori më të ulët**

---

1. Një person juridik, një shoqatë ose një klub mund të zbritet në një kategori më të ulët.

---

### **Neni 29 Zbritje e pikëve në klasifikim**

---

1. Një personi juridik, një shoqatë ose një klubi mund t'i zbriten pikë nga pikët që ka përfutuar në klasifikimin e garës ose kampionatit aktual ose të ardhshëm.

---

### **Neni 30 Humbja e ndeshjes në tavolinë**

---

1. Nëse një ndeshje nuk mund të zhvillohet ose nuk mund të përfundojë, subjektet anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitet humbasin ndeshjen në tavolinë.
2. Ndeshja shpallet e humbur në tavolinë, edhe nëse në atë ndeshje merr pjesë një lojtar, që duhej të vuante dënimin me pezullim në atë ndeshje sipas një vendimi disiplinor.
3. Një ndeshje mund të shpallet e humbur në tavolinë edhe nëse merr pjesë në ndeshje një lojtar, i cili nuk është i përzgjedhur të luante sipas rregullave të aktivitetit përkatës, në rast se skuadra kundërshtare paraqet një protestë.
4. Pasojat e një ndeshjeje të deklaruar si të humbur në tavolinë janë si më poshtë:
  - a. ekipi që humbet ndeshjen konsiderohet ta ketë humbur 3 – 0 (5 – 0 në rastin e futbollit në sallë), përveç rastit kur rezultati aktual i fushës është më pak i favorshëm për shoqatën anëtare ose klubit në faj, rast në të cilin rezultati qëndron i njëjtë;
  - b. nëse është e nevojshme, administrata FSHF ndryshon renditjen e subjektit anëtar ose pjesëmarrës në aktivitetin përkatës në përputhje me rrethanat.
5. Nëse një ndeshje shpallet e humbur, shkeljet e kryera gjatë ndeshjes mbeten të dënueshme.

**SEKSIONI 3.**

## Përcaktime të përgjithshme

**Neni 31 Dënimet e kombinuara**

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe, dënimet e përcaktuara në Kreun I (Pjesa e Përgjithshme) dhe në Kreun II (Pjesa e Posaçme) të këtij Kodi, mund të kombinohen.

**Neni 32 Pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimeve**

1. Organi gjykues i cili shpall vendimet për dënimet si në vijim: pezullim nga ndeshja (Seksioni 2. Neni 19); ndalim i qëndrimin në dhomën e zhveshjes dhe në stolin e rezervave (Seksioni 2. Neni 20); ndalim i pjesëmarrjes në ndonjë veprimtari futbolistike (Seksioni 2. Neni 22); zhvillim i ndeshjes pa spektatorë (Seksioni 2. Neni 24); zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjane (Seksioni 2. Neni 25); ose, ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar (Seksioni 2. Neni 26); mund të vlerësojë nëse është i mundur pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimit përkatës.
2. Pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimit është i mundur vetëm nëse periudha e dënimit nuk kalon më shumë se 8 (tetë) ndeshje, ose 8 (tetë) muaj, dhe nëse rrethanat përkatëse e lejojnë, sidomos sjellja e mëparshme e të dënuarit.
3. Organi gjykues vendos se cila pjesë e dënimit mund të pezullohet. Në çdo rast gjysma e dënimit do të zbatohet detyrimisht.
4. Duke pezulluar pjesërisht zbatimin e dënimit, organi gjykues vendos një periudhë pezullimi me kusht nga 6 (gjashtë) deri në 24 (njëzet e katër) muaj.
5. Nëse i dënuari që përfiton një pezullim të pjesshëm të zbatimit të dënimit, kryen ndonjë shkelje brenda periudhës së pezullimit me kusht të vendosur, pezullimi i pjesshëm anulohet

automatikisht dhe fillon zbatimi i menjëhershëm i dënimit të pezulluar; dënimi i pezulluar i shtohet dënimit të ri që vendoset për shkëljen e kryer prej të dënuarit.

6. Ky nen nuk është i zbatueshëm në rastin e verifikimit dhe dënimit për doping.

---

### **Neni 33 Dënimet kohore: përlllogaritja e periudhës**

---

1. Periudha e një dënimi kohor mund të ndërpritet përkohësisht nga periudhat e pushimit gjatë ose në përfundim të sezoneve.

---

### **Neni 34 Centralizimi i dënimeve**

---

1. Të dhënat për masat ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë), masat ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq), dhe pezullimi nga ndeshja regjistrohen pranë organeve kompetente të FSHF. Sekretaria e Komisionit të Disiplinës njofton me shkrim ose publikon dënimet e përmendura më sipër. Publikimi i dënimit ka të njëjtin efekt me njoftimin me shkrim.
2. Ky komunikim shërben vetëm si konfirmim: dënimet (kartoni i verdhë, kartoni i kuq, dhe pezullimi nga ndeshja) kanë një efekt të menjëhershëm edhe nëse shkresa e konfirmimit mund të arrijë pranë klubit ose individit të interesuar më vonë.

## **SEKSIONI 4.**

Mbartja dhe anulimi i masave ndëshkimore  
(kartonat) dhe pezullimi nga ndeshja

---

### **Neni 35 Mbartja e masave ndëshkimore**

---

1. Masat ndëshkimore (karton i verdhë, karton i kuq) të marra gjatë një gare ose kampionati nuk mbarten në një garë ose kampionat tjetër.

2. Gjithsesi, masat ndëshkimore (karton i verdhë, karton i kuq) mbarten nga një raund në një raund tjetër të së njëjtës garë ose kampionat.

---

### **Neni 36 Anullimi i masave ndëshkimore**

---

1. Vendimet e marra nga arbitri në fushën e lojës janë përfundimtare dhe nuk mund të rishikohen nga organet disiplinore të FSHF-së.
2. Në rastet kur një vendim nga arbitri përbën një gabim të dukshëm (siç është gabimi i identitetit të personit të penalizuar), vetëm pasojat disiplinore të këtij vendimi mund të rishikohen nga organet disiplinore. Në rastet e identitetit të gabuar, procedurat disiplinore mund të hapen në përputhje me këto rregullore vetëm ndaj personit që është në të vërtetë fajtor.
3. Kundërshtimi i një mase ndëshkimore (karton i verdhë, karton i kuq) pas dy paralajmërimeve, është i pranueshëm vetëm nëse gabimi i arbitrit do të ishte ngatërrimi i identitetit të lojtarit.
4. Në rastet e sjelljes së keqe, masa disiplinore mund të merret edhe nëse arbitri dhe/ose asistentët e tij nuk e kanë vënë re sjelljen në fjalë dhe për këtë arsye nuk kanë qenë në gjendje të ndërmarrin ndonjë veprim disiplinor.

---

### **Neni 37 Mbartja e pezullimit nga ndeshja**

---

1. Përveç rasteve kur organi kompetent disiplinor vendos ndryshe, vendimet disiplinore duhet të zbatohen gjatë ndeshjes së radhës në aktivitetin në të cilin është kryer shkelja në fjalë;
2. Pezullimi nga ndeshja mbartet nga një raund në një tjetër, dhe nga një sezon në një sezon tjetër, të së njëjtës garë ose kampionat.
3. Pezullimi nga ndeshja që ka rezultuar nga marrja e disa masave ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) në

ndeshje të ndryshme, nuk mund të mbartet nga një garë ose kampionat në një tjetër

## **SEKSIONI 5.**

Përlllogaritja e dënimit

---

### **Neni 38 Rregulli i përgjithshëm**

---

1. Organi gjykues i cili shpall dënimin përcakton dhe kohëzgjatjen e dënimit.

---

### **Neni 39 Shkeljet e përsëritura**

---

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe, organi gjykues mund të rrisë masën e dënimit siç e gjykon të arsyeshme nëse një shkelje është e përsëritur.
2. Përcaktimet në këtë nen janë subjekt i përcaktimeve të veçanta në lidhje me shkeljet e rregullave anti-doping.

---

### **Neni 40 Shkeljet e njëkohshme**

---

1. Për shkeljet e kryera në mënyrë të njëkohshme, dënimet përkatëse për çdo shkelje mblidhen së bashku.

## **SEKSIONI 6.**

Parashkrimi

---

### **Neni 41 Parashkrimi për gjykim**

---

1. Shkeljet e kryera gjatë një ndeshje nuk mund të ndiqen nga organet gjykuese nëse kalon më shumë se 2 (dy) vjet. Si rregull



- të gjitha shkeljet e tjera nuk mund të ndiqen nëse kalon më shumë se 10 (dhjetë) vjet.
2. Shkeljet e rregullave anti-doping nuk mund të ndiqen nëse kalon më shumë se 8 (tetë) vjet.
  3. Ndjekja për korrupsion ose trukim të rezultatit nuk është subjekt i parashkrimit.

---

**Neni 42 Fillimi i periudhës së parashkrimit**

---

1. Fillimi i periudhës së parashkrimit llogaritet si më poshtë:
  - a) që nga dita kur shkelësi ka kryer shkeljen përkatëse;
  - b) nëse shkelja është e përsëritur, që nga dita kur është kryer shkelja më e fundit;
  - c) nëse shkelja ka zgjatur për një periudhë të caktuar, që nga dita kur shkelja ka përfunduar.

---

**Neni 43 Ndërprerja e periudhës së parashkrimit**

---

1. Periudha e parashkrimit ndërpritet në momentin kur Komisioni i Disiplinës fillon procedurën e ndjekjes së shkeljes përkatëse, përpara skadimit të periudhës së parashkrimit.

---

**Neni 44 Periudha e parashkrimit për zbatimin e dënimeve**

---

1. Periudha e parashkrimit për zbatimin e dënimeve është 5 (pesë) vjet.
2. Periudha e parashkrimit fillon që prej ditës kur hyn në fuqi vendimi i dënimit përkatës.

## PJESA E POSAÇME

### SEKSIONI 7.

#### Shkeljet e Ligjeve të Lojës

---

#### Neni 45 Shkeljet e lehta

---

1. Ndaj një lojtari merret masë ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) nëse ai kryen një nga shkeljet e përcaktuara më poshtë:
  - a) sjellje josportive;
  - b) kundërshtime me fjalë ose me veprime;
  - c) shkelje e vazhdueshme e Ligjeve të Lojës;
  - d) vonesa në fillimin e lojës;
  - e) mos respektimi i distancës së kërkuar kur riniset loja nga goditje këndi, goditje e lirë, ose rivënie anësore;
  - f) hyrja në fushën e lojës pa lejen e arbitrit; verifikimi i këtij rasti dënohet edhe me pezullim nga ndeshja për të paktën 2 (dy) ndeshje;
  - g) dalja nga fusha e lojës me paramendim pa lejen e arbitrit; verifikimi i këtij rasti dënohet edhe me pezullim për jo më pak se 4 (katër) ndeshje.

---

#### Neni 46 Shkeljet e rënda

---

1. Ndaj një lojtari merret masë ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq) nëse ai kryen një nga shkeljet e përcaktuara më poshtë:
  - a) lojë e rëndë duke shkaktuar faull;
  - b) sjellje e dhunshme;

- c) pështymja e një kundërshtari ose e ndonjë personi tjetër;
- d) ndalimi i kryerjes së një goli nga ekipi kundërshtar, ose ndalimi i një aksioni të qartë goli të ekipit kundërshtar duke e prekur topin me dorë (ky përcaktim nuk zbatohet për portierin i cili e prek topin brenda zonës së penalltisë);
- e) ndalimi i një aksioni të qartë goli të ekipit kundërshtar duke kryer një faull të dënueshëm me goditje të lirë ose me penallti, ndërkohë që ekipi kundërshtar drejtohet drejt portës së shkelësit;
- f) përdorimi i fjalëve të pista, sharjeve dhe gjuhës ofenduese, dhe/ose gjesteve ofenduese;
- g) marrja e një mase ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) të dytë.

## SEKSIONI 8.

Rrëmuajt gjatë ndeshjeve ose garave

### **Neni 47 Sjellja e keqe ndaj kundërshtarëve dhe çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes**

1. Duke përfshirë dhe pezullimin automatik nga ndeshja në përputhje me Seksioni 2. Neni 18 - 3, çdo lojtar i cili ndëshkohet me një masë ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq) i drejtpërdrejtë, do të pezullohet si më poshtë:
  - a) 1 (një) ndeshje për ndalimin e një aksioni të qartë goli të ekipit kundërshtar, veçanërisht duke e prekur topin me dorë në mënyrë të qëllimshme;
  - b) të paktën 1 (një) ndeshje për lojë të rëndë, veçanërisht nëse përdoret dhunë fizike;
  - c) të paktën 6 (gjashtë) muaj për lojë të rëndë, veçanërisht nëse përdoret dhunë fizike, duke shkaktuar dëmtimin e rëndë të lojtarit kundërshtar;

- d) të paktën 1 (një) ndeshje për sjellje josportive ndaj kundërshtarëve ose personave të tjerë përveç zyrtarëve të ndeshjes;
  - e) të paktën 5 (pesë) ndeshje për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj kundërshtarëve ose çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes;
  - f) të paktën 6 (gjashtë) ndeshje për pështymjen ndaj një kundërshtari ose personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes.
2. Kur personi që ushtron sjellje të keqe ndaj personave të tjerë, përveç zyrtarëve të ndeshjes, është trajner ose zyrtar i personit juridik, shoqatës, ose klubit ku bën pjesë ekipi përkatës, atëherë trajneri ose zyrtari dënohen si më poshtë:
- a) të paktën 3 (tre) ndeshje për sjellje josportive ndaj kundërshtarëve ose personave të tjerë përveç zyrtarëve të ndeshjes;
  - b) të paktën 9 (nëntë) ndeshje për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj kundërshtarëve ose çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes;
  - c) të paktën 12 (dymbëdhjetë) ndeshje për pështymjen ndaj një kundërshtari ose personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes.
3. Sipas rastit, trupa gjykuese mund të aplikojë edhe një gjobë me vlerë maksimale 100.000 (njëqindmijë) Lekë;
4. Pavarësisht se ndaj lojtarit i cili çënon ndonjë person përveç zyrtarëve të ndeshjes, nëpërmjet sjelljes së keqe, nuk merret masë ndëshkimore me largim nga ndeshja (karton i kuq), organet disiplinore kanë të drejtë të zbatojnë dënimet e përcaktuara në paragrafin 1., pikat (a), (b), (c), (d), (e), dhe (f) si dhe dënimin me gjobë në paragrafin 2, të këtij neni.

**Neni 48 Sjellja e keqe ndaj zyrtarëve të ndeshjes**

1. Një lojtari që dënohet me masën ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq) i drejtpërdrejtë, pavarësisht pezullimeve të dhëna në përputhje me Seksioni 2. Neni 18 - 3, do t'i jepen dhe pezullimet si më poshtë:
  - a) të paktën 4 (katër) ndeshje për sjellje josportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
  - b) të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
  - c) të paktën 24 (njëzet e katër) muaj për pështymjen ndaj zyrtarëve të ndeshjes.
2. Kur personi që ushtron sjellje të keqe ndaj zyrtarëve të ndeshjes është trajner ose zyrtar i personit juridik, shoqatës, ose klubit ku bën pjesë ekipi përkatës, atëherë trajneri ose zyrtari dënohen si më poshtë:
  - a) të paktën 8 (tetë) ndeshje për sjellje josportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
  - b) të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) muaj për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
  - c) të paktën 24 (njëzet e katër) muaj për pështymjen ndaj zyrtarëve të ndeshjes.
3. Sipas rastit trupa gjyquese mund të aplikojë edhe një masë dënimi me gjobë me vlerë maksimale deri në 1.000.000 (njëmilion) Lekë.
4. Pavarësisht se ndaj lojtarit i cili cënon zyrtarët e ndeshjes nëpërmjet sjelljes së keqe, nuk merret masë ndëshkimore me largim nga ndeshja (karton i kuq), organet juridike kanë të drejtë të zbatojnë dënimet e përcaktuara në paragrafin 1, pikat (a), (b), dhe (c), si dhe dënimin me gjobë në paragrafin 2, të këtij neni.

---

#### **Neni 49 Grindja**

---

1. Përfshirja në një grindje dënohet me një pezullim nga ndeshjet për të paktën 6 (gjashtë) ndeshje, si dhe dënohet me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë.
2. Kushdo që është përpjekur për të parandaluar një grindje, për të mbrojtur të tjerët ose për të ndarë personat e përfshirë në grindje nuk është subjekt i dënimit.

---

#### **Neni 50 Agresorët e paidentifikuar**

---

1. Nëse, në rastin e grindjeve dhe akteve të dhunës, nuk është i mundur identifikimi i shkelësit ose shkelësve, organi gjykues do të dënojë personin juridik, shoqatën ose klubin ku përkasin agresorët që kryejnë grindjen ose aktin e dhunës.

### **SEKSIONI 9.**

#### **Sjellja e ekipeve**

---

#### **Neni 51 Nxitja e urrejtjes dhe akteve të dhunës**

---

1. Një lojtar ose një zyrtar i cili publikisht nxit të tjerët për urrejtje ose akte të dhunës do të dënohet me pezullim nga gara për 12 (dymbëdhjetë) muaj, si dhe me gjobë me vlerë jo më pak se 100,000 (njëqind mijë) Lekë.
2. Në raste të rënda, kur nxitja kryhet duke përdorur median (televizioni, radio, ose shtypi i shkruar) ose nëse kryhet pranë stadiumit gjatë ditës së ndeshjes, vlera e gjobës do të jetë jo më pak se 100.000 (njëqind mijë) deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.
3. Një lojtar ose një zyrtar i cili para, gjatë ose pas ndeshjes shpif ose përhap me dashje fakte të pavërteta për personat juridikë, shoqatat, klubet, zyrtarët e FSHF-së, lojtarët, ose zyrtarët e ndeshjes, dënohet me pezullim nga ndeshjet për një periudhë

nga 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënohet me gjobë me një vlerë prej 300,000 (treqind mijë) Lekë.

---

#### **Neni 52 Provokimi i publikut**

---

1. Kushdo që provokon publikun gjatë një ndeshje do të dënohet me pezullim nga gara për 2 (dy) ndeshje.
2. Sipas rastit trupa gjykuese mund të aplikojë edhe një masë dënimi me gjobë me vlerë maksimale deri në 500.000 (pesëqindmijë) Lekë.

---

#### **Neni 53 E drejta për të luajtur**

---

1. Nëse një lojtar merr pjesë në ndeshje zyrtare pavarësisht se ai nuk kishte të drejtë të luante (nuk është i federuar, është i pezulluar nga ndeshja, luan si lojtar i huaj duke shkelur përcaktimet e vendosura nga Rregullorja e Veprimtarisë Futbollistike etj) atëherë ekipi i tij do të dënohet me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3 - 0 si, me gjobë me vlerë jo më pak se 600.000 lekë dhe me zbritje jo më pak se 3 pikëve nga klasifikimi.

---

#### **Neni 54 Braktisja**

---

1. Nëse një ekip refuzon të luajë një ndeshje ose të vazhdojë të luajë një ndeshje që ka filluar, atëherë ekipi do të dënohet me humbjen e ndeshjes përkatëse në tavolinë me rezultatin 3 - 0 (tre me zero), zbritjen e jo më pak se 3 (tre) pikëve nga klasifikimi. Kur gara është me sistem eliminimi ai ekip dënohet me mospjesëmarrje në atë garë në sezonin pasardhës.
2. Në raste të rënda ekipi do të skualifikohet nga vazhdimi i kampionatit apo garës ku merr pjesë, dhe dënohet me zbritje në një kategori më të ulët. Kur gara është me sistem eliminimi ai ekip dënohet me mospjesëmarrje në atë garë për të paktën 2 (dy) sezonet pasardhës.

3. Trajneri, ose ndonjë zyrtar i ekipit i cili nxit braktisjen e ndeshjes nga ekipi përkatës, do të dënohet me pezullim nga veprimtaritë futbolistike për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, si dhe me gjobë me vlerë jo më pak se 200,000 (dyqind mijë) Lekë.

## **SEKSIONI 10.**

### **Sjelljet ofenduese dhe diskriminuese**

---

#### **Neni 55 Sjellja ofenduese dhe fair play**

---

1. Kushdo që ofendon një person në çfarëdo lloj mënyre, sidomos duke përdorur gjeste dhe gjuhë ofenduese, ose nëse shkel parimet e fair play, ose kryen sjellje josportive në çfarëdo lloj mënyre, mund të dënohet me përjashtim nga veprimtaritë, nga garat dhe/ose kampionatet kombëtare.
2. Trajneri ose lojtari i cili proteston ndaj vendimeve të arbitrit me gjeste ose fjalë ofenduese, dënohet me pezullim nga aktivitetet për të paktën dy ndeshje. Sipas rastit, trupa gjykuese mund të aplikojë edhe një gjobë me vlerë maksimale 100.000 (njëqindmijë) Lekë;

---

#### **Neni 56 Diskriminimi**

---

1. Kushdo që ofendon dinjitetin e një personi apo grupi personash nëpërmjet fjalëve ose veprimeve përçmuese, diskriminuese ose denigruese në lidhje me racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, ose origjinën do të pezullohet për të paktën 5 (pesë) ndeshje. Gjithashtu, do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 100.000 (njëqind mijë) Lekë.
- 2) Kur persona të ndryshëm (zyrtarë ose lojtarë) të të njëjtit klub, person juridik, ose shoqatë shkelin njëkohësisht paragrafin 1.(a) të këtij neni, ose ekzistojnë rrethana



rënduese, ekipi në fjalë do të dënohet me zbritje të 3 (tre) pikëve në klasifikim, dhe në rast të përsëritjes së kësaj shkelje dënohet me zbritje të 6 (gjashtë) pikëve, dhe në rast të përsëritjes së tretë të kësaj shkelje ekipi do të zbritet në një kategori më të ulët, ose për veprimtaritë me sistem eliminimi, skualifikim nga gara dhe ndalim i pjesëmarrjes në të njëjtën garë sezonin pasardhës.

- 3) Shkeljet me rrethana rënduese ose shkeljet e përsëritura dënohen edhe me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3 - 0 (tre me zero), dhe zbritjen e 3 (tre) pikëve nga klasifikimi.

## SEKSIONI 11.

### Cënimi i lirisë personale

#### Neni 57 Kërcënimet

1. Kushdo që kërcënon një zyrtar ndeshje do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 1,000,000 (një milion) Lekë.
2. Nëse kërcënimi kryhet gjatë zhvillimit të një ndeshje, ekipi ku bën pjesë personi që kryen kërcënimin ndaj zyrtarëve të ndeshjes, do të dënohet me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3 - 0 (tre me zero), dhe zbritjen e 3 (tre) pikëve nga klasifikimi.

#### Neni 58 Shtrëngimi

1. Kushdo që përdor dhunë ose kërcënime për të ndikuar ose shtrënguar një zyrtar ndeshje, që ky i fundit të kryejë veprime të caktuara ose dhe thjesht moslejimin e zyrtarit të ndeshjes për të vepruar lirisht, do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë.

## SEKSIONI 12.

### Mashtrimi dhe falsifikimi

#### Neni 59 Dokumentacioni

1. Kushdo që falsifikon dokumentacionin gjatë veprimtarive futbolistike do të dënohet me pezullim nga ndeshjet për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj.
2. Gjithashtu në çdo rast, shkelësi do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 100,000 (njëqind mijë) Lekë.

## SEKSIONI 13.

### Korrupsioni

#### Neni 60 Korrupsioni

1. Kushdo që ofron, premtan, ose dhuron një favor ndaj një organi ose zyrtari të FSHF-së, një zyrtari të ndeshjes, një lojtari ose një zyrtari, për llogari të vetë apo për llogari të një pale të tretë duke u përpjekur për të nxitur personin përkatës të shkelë rregulloret e FSHF-së, do të dënohet si në vijim:
  - a) me gjobë me një vlerë jo më pak se 1,000,000 (një milion) Lekë;
  - b) me përjashtim nga veprimtaritë futbolistike për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet;
  - c) me përjashtim për mos hyrje në ndonjë stadium për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet;
  - d) dënimet këtu më sipër vendosen së bashku.
2. Korrupsioni pasiv (kërkesa, marrja e premtimeve ose pranimi i favoreve të pajustificuara) do të dënohet njësoj si në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Në rrethana rënduese, ose në rast të përsëritjes, dënimi i përcaktuar në paragrafin 1. (b) mund të shpallet për një periudhë përgjithmonë.
4. Në çdo rast, organi gjykues urdhëron konfiskimin e vlerave të shfrytëzuara për kryerjen e shkeljes. Vlerat duhet të depozitohen pranë FSHF-së, dhe do të përdoren për programe zhvillimi në sportin e futbollit.

## SEKSIONI 14.

### Dopingu

---

#### Neni 61 Përkufizimi dhe rregullat

---

1. Dopingu është i ndaluar.
2. Lojtari që nuk pranon të kryejë kontrollin anti-doping, pezullohet nga ndeshjet për një periudhë nga 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënohet me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë.

## SEKSIONI 15.

### Dështimi në respektimin e vendimeve

---

#### Neni 62 Vendimet dhe pagesat

---

1. Kushdo që dështon për të paguar një person (si një lojtar, një trajner ose një klub) ose FSHF-në për ndonjë shumë parash plotësisht ose pjesërisht, edhe pse është urdhëruar nga ndonjë organ ose komision i FSHF-së (vendime financiare), ose kushdo që dështon në përmbushjen e ndonjë vendimi tjetër (vendime jofinanciare) të lëshuar nga ndonjë organ ose komision i FSHF-së:

- a) do t'i jepet një afat paralajmërues jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga organi gjykues i FSHF-së, për të paguar detyrimet për vendimet financiare, dhe për të përmbushur vendimin jo-financiar;
- b) lojtarët të cilët me vendim të organeve gjyquese të FSHF kanë detyrime financiare të papaguara nuk do të aktivizohen deri në shlyerjen e detyrimeve.
- c) (vetëm për personat juridikë, shoqatat ose klubet:) me skadimin e afatit paralajmërues në rast se dështojnë në përmbushjen e detyrimeve financiare ose të përmbushjes së vendimit jo-financiar, atëherë klubi përkatës do të dënohet me zbritje të pikëve në klasifikim me jo më pak se 3 (tre) pikë, dhe do t'i jepet një afat përfundimtar jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga organi gjykues i FSHF-së, për të paguar detyrimet për vendimet financiare, dhe për të përmbushur vendimin jofinanciar;
- d) (vetëm për personat juridikë, shoqatat ose klubet:) me skadimin e afatit paralajmërues prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, në rast dështimi në përmbushjen e detyrimeve financiare ose të përmbushjes së vendimit jo-financiar, atëherë klubi përkatës do të dënohet me zbritje të pikëve në klasifikim me jo më pak se 3 (tre) pikë, dhe do t'i jepet një afat përfundimtar jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë nga organi gjykues i FSHF-së, për të paguar detyrimet për vendimet financiare, dhe për të përmbushur vendimin jofinanciar;
- e) (vetëm për personat juridikë, shoqatat ose klubet:) me skadimin e afatit përfundimtar në rast se dështojnë në përmbushjen e detyrimeve financiare ose të përmbushjes së vendimit jofinanciar, atëherë klubi përkatës do të dënohet me zbritje në një kategori më të ulët.

**SEKSIONI 16.**

Përgjegjësitë e personave juridikë, shoqatave dhe klubeve

**Neni 63 Organizimi i ndeshjeve**

1. Subjektet anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitete që organizojnë ndeshjet zyrtare si fusha pritëse duhet të përmbushin përcaktimet si më poshtë:
  - a. të vlerësojnë nivelin e riskut për çdo ndeshje që zhvillohet në fushën e administruar prej tyre dhe të njoftojnë menjëherë organet e FSHF për ndeshjet të cilat paraqesin nivel të lartë të riskut;
  - b. të përmbushin dhe të zbatojnë rregullat e sigurisë (rregullat përkatëse të FSHF-së, dhe/ose legjisllacionin në fuqi) dhe të ndër marrin hapat e nevojshëm për garantimin e sigurisë përpara, gjatë dhe pas ndeshjes, si dhe nëse ndodhin incidente të mundshme;
  - c). të garantojnë sigurinë e zyrtarëve të ndeshjes, lojtarëve dhe zyrtarëve të klubit kundërshtar gjatë qëndrimit të tyre kur zhvillohen ndeshje në fushën e tyre;
  - d. të mbajnë kontakt dhe të bashkëpunojnë me autoritetet vendore (pushtetin vendor, policinë e rendit) në mënyrë efektive;
  - e. të garantojnë zbatimin e ligjit dhe të mbajnë rregullin dhe qetësinë në stadium dhe rrethinat e stadiumit dhe ndeshjet të zhvillohen në rregull.

**Neni 64 Dështimi në përmbushjen e përgjegjësiave**

1. Subjektet anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitete që dështojnë në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësiave të tyre në përputhje me Neni 64 do të dënohen me gjobë.

2. Në rastet e shkeljeve të rënda mund të ndërmerren dënime të tjera, si zhvillim i ndeshjes pa spektatorë, zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjëherë, ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në stadiumin përkatës, anulimi i rezultatit të ndeshjes, përjashtimi nga një garë ose kampionat, dhe/ose humbje e ndeshjes në tavolinë.
3. Subjektet anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitete që organizojnë ndeshjet zyrtare si fusha pritëse do të dënohen si më poshtë:
  - a. në rastin e hyrjes brenda pjesës së rrethuar të fushës së lojës të ndonjë personi, pa shkaktuar akte të dhunës ose ndërprerje të lojës, ekipi përgjegjës për sigurinë në stadium do të penalizohet me zhvillimin e 1 (një) ndeshje pa spektatorë.
  - b. në rastin e hyrjes brenda pjesës së rrethuar të fushës së lojës të ndonjë personi, duke shkaktuar akte të dhunës ndaj lojtarëve në fushë, dhe /ose zyrtarëve të ndeshjes, dhe/ose ndërprerje të lojës, ekipi përgjegjës për sigurinë në stadium do të penalizohet me zhvillimin e të paktën 4 ndeshjeve pa spektatorë. Në rast se nga këto akte shkaktohet ndërprerja përfundimtare e ndeshjes, ekipi përgjegjës për sigurinë do të penalizohet me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3-0 përveç dënimeve të tjera.
4. Kur dështimi në përmbushjen e përgjegjësive është shkaktuar nga ekipi jo organizator i ndeshjes apo nga lojtarët a zyrtarët e tij, ky ekip do të jetë subjek i të njëjtave penaltete siç parashikohen në paragrafin 3 të këtij neni.
5. Organi gjykues ka të drejtë të vendos dënime edhe nëse nuk është verifikuar ndonjë shkelje e përcaktimeve këtu në këtë kod, por thjesht për çështje të mospërmbushjes së standardeve të sigurisë.

**Neni 65 Përgjegjësia për sjelljen e spektatorëve**

1. Personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet mikpritëse të ndeshjeve janë përgjegjëse për sjelljen e gabuar të spektatorëve, pavarësisht se faji mund të kryhet me vetëdije apo pa vetëdije, dhe si rrjedhim dënohen me gjobë në çdo rast. Mund të vendosen edhe dënime të tjera në rastin e verifikimit të ngjarjeve të rënda.
2. Personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet mike janë përgjegjëse për sjelljen e gabuar të grupit të tyre të spektatorëve, pavarësisht se faji mund të kryhet me vetëdije apo pa vetëdije, dhe si rrjedhim dënohen me gjobë në çdo rast. Mund të vendosen edhe dënime të tjera në rastin e verifikimit të ngjarjeve të rënda. Nëse nuk provohet e kundërta, tifozët të cilët qëndrojnë në sektorin e miqve në stadium konsiderohen si tifozë ose mbështetës të ekipit mik (personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet mike).
3. Gjatë veprimtarive futbolistike të organizuara nga FSHF nuk lejohet provokimi me karakter politik, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve dhe ndalohen sjelljet e mëposhtme:
  - a. Mbajtja dhe përdorimi i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, si dhe armëve të të gjitha llojeve;
  - b. sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve;
  - c. hedhja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve;

- d. shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyen ndjenjat kombëtare ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor;
  - e. ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike;
  - f. dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv;
  - g. veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë;
  - h. hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv;
  - i. hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik;
  - j. djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj. ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv;
  - k. përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës;
  - l. Përdorimi i dritave lazer apo dronëve.
4. Në rastin e verifikimit të shkeljeve të mësipërme, ndaj personave juridikë, shoqatave dhe/ose klubeve ku konsiderohen si mbështetës spektatorët kundërvajtës, do të jepen dënimet si më poshtë:
- a. rastet e verifikimit të sjelljeve të përshkruara në paragrafin 3, pa shkaktuar akte të dhunës ose ndërprerje të lojës, sanksionohen me dënimin gjobë.
  - b. rastet e verifikimit të sjelljeve të përshkruara në paragrafin 3, që shkaktojnë akte të dhunës ose ndërprerje të përkohshme të lojës, sanksionohen zhvillimit të jo më pak se 4 (katër) ndeshje pa spektatorë;



- c. rastet e verifikimit të sjelljeve të përshkruara në paragrafin 3, që shkaktojnë akte të dhunës ndaj zyrtarëve të ndeshjes dhe ndërprerje të përkohshme të lojës, sanksionohen zhvillimit të jo më pak se 6 (gjashtë) ndeshje pa spektatorë;
  - d. rastet e verifikimit të sjelljeve të përshkruara në paragrafin 3, që shkaktojnë akte të dhunës ose ndërprerje përfundimtare të lojës, sanksionohen humbje të ndeshjes në tavolinë dhe zhvillimin e jo më pak se 8 (tetë) ndeshje pa spektatorë;
5. Në rastin e ofendimeve në grup, me karakter politik, racial, fetar a gjinor gjatë zhvillimit të një ndeshje, arbitri i ndeshjes do të zbatojë hapat në vijim:
- a. paralajmërim i sektorit përkatës në stadium nga vijnë ofendimet, për të pushuar lëshimin e ofendimeve;
  - b. nëse ofendimet vazhdojnë, do të urdhërojnë zbrazjen e sektorit përkatës nga spektatorët duke pritur 10 (dhjetë) minuta;
  - c. në rast të mos zbrazjes së sektorit përkatës nga spektatorët, urdhëron ndërprerjen e ndeshjes.
6. Rastet e parashikuara në pikën 5 (c) të këtij neni dënohen me humbje të ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3-0 (tre me zero) në dëm të personit juridik, shoqatës ose klubit të cilit i përkasin spektatorët.

---

## Neni 66 Detyrime të tjera

---

1. Personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet duhet:
  - a. të garantojnë se nuk do të përfshihet në menaxhimin e klubit, asnjë person që mund të jetë në ndjekje ligjore për shkak të përfshirjes në çështje doping, të korrupsionit, ose fallsifikimit, ose asnjë person i cili është shpallur fajtor për çështje penale brenda 5 (pesë) viteve të fundit.

Influencimi në mënyrë të paligjshme i rezultatit të ndeshjes

---

**Neni 67 Trukimi i ndeshjeve**

---

1. Të gjithë subjektet anëtar ose pjesëmarrës në aktivitet që i nënshtrohen rregullave dhe rregulloreve të FSHF-s duhet të shmangin çdo sjellje që dëmton ose mund të dëmtojë integritetin e ndeshjeve dhe/ose aktiviteve dhe duhet të bashkëpunojë plotësisht me FSHF-në, në çdo kohë në përpjekjet e saj për të luftuar një sjellje të tillë.
2. Integriteti i ndeshjeve dhe i aktiviteve konsiderohet i shkelur, nga kushdo që:
  - a. vepron në një mënyrë të atillë që mund të ushtrojë një ndikim të paligjshëm ose të padrejtë në rrjedhën dhe/ose rezultatin e një ndeshjeje ose aktiviteti me qëllim përfitimin e një avantazhi për vete ose për një palë të tretë;
  - b. merr pjesë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në baste ose aktivite të ngjashme që lidhen me ndeshjet e aktivitetet ose që kanë një interes financiar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në këto aktivite;
  - c. përdor apo u siguron të tjerëve informacione që nuk janë në dispozicion të publikut, informata që përftohen nëpërmjet pozitës së tij në futboll dhe dëmton ose mund të dëmtojë integritetin e një ndeshjeje ose aktiviteti;
  - d. nuk informon menjëherë dhe vullnetarisht FSHF-në në rast se kontaktohet në lidhje me aktivitetet që synojnë të ndikojnë në një mënyrë të paligjshme ose të padrejtë në rrjedhën dhe/ose rezultatin e një ndeshjeje ose aktiviteti;
  - e. nuk raporton menjëherë dhe vullnetarisht tek FSHF- ndonjë sjellje që ai është në dijeni se mund të përfshihet në kuadër të këtij neni.
3. Për aq sa këto shkelje rregullohen nga Kodi i Etikës së FSHF, ato gjykohen nga Komisioni i Etikës në referim të Nenit 42/2 të Statutit të FSHF.

## TITULLI III ORGANIZIMI DHE PROCEDURAT

### Kreu I

### Organizimi

#### SEKSIONI 1.

Juridiksioni i FSHF-së

#### Neni 68 Rregulli i përgjithshëm

1. Të gjitha ndeshjet zyrtare ose miqësore që organizohen nga FSHF, janë nën juridiksionin e organeve gjyquese të FSHF-së. Dënimet të cilat vendosen nga këto organe kanë efekt në të gjithë botën.
2. FSHF do të njoftojë organet e FIFA-s në rastin e verifikimit të shkeljeve të rënda të objektivave statutore të FIFA-s.
3. FIFA mund të dënojë këdo që shkel objektivat statutore të FIFA-s.

#### Neni 69 Ndeshjet miqësore midis përfaqësueseve

1. Çdo veprim disiplinor që ndërmerret gjatë një ndeshje miqësore ndërmjet ekipit përfaqësues të vendit tonë dhe ekipit përfaqësues të ndonjë federate tjetër, ndaj lojtarëve të ekipit përfaqësues të vendit tonë, do të dënohet nga organet gjyquese të FSHF-së.
2. FSHF do të njoftojë FIFA-n për dënimet e vendosura në çdo rast.
3. FIFA ka të drejtë të verifikojë përputhshmërinë e dënimeve të vendosura sipas përcaktimeve të Kodit të Disiplinës, të FIFA-s.

---

**Neni 70 Organet disiplinore**

---

1. Organet disiplinore janë:
  - a. Komisioni i Disiplinës;
  - b. Organi i Apelit.
  - c. Komisioni i Etikës.
2. Anëtarët e Komisionit të Disiplinës, e të Apelit zgjidhen nga Komiteti Ekzekutiv për një mandat katërvjeçar. Anëtarët e Komisionit të Etikës zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat katërvjeçar.
3. Nëse një pozicion ngelet vakant, Komiteti Ekzekutiv i FSHF—së mund të zgjedhë një zëvendësues për pjesën e mbetur të mandatit.

---

**Neni 71 Komisioni i Disiplinës**

---

1. Komisioni i Disiplinës përbëhet nga një kryetar, dy nënkryetarë dhe shtatë anëtarë të tjerë. Si rregull, Komisioni i Disiplinës merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve të tij, por ka të drejtë të marrë vendime nëse janë të pranishëm së paku tre nga anëtarët e tij.
2. Kryetari i Komisionit të Disiplinës, një nga nënkryetarët e tij ose një prej anëtarëve të tij që vepron si kryetar në rastin konkret, mund të marrë vendim si gjyqtar i vetëm:
  - a. në raste urgjente ose protesta; ose
  - b. në rastet kur sanksioni i vendosur është një paralajmërim, një qortim, një gjobë deri në 50.000 Lekë, ose një pezullim nga ndeshjet ose kryerja e një funksioni për deri në tre ndeshje.

3. Komisioni i Disiplinës, ka juridiksion për të vendosur mbi çështjet disiplinore dhe për të gjitha çështjet e tjera që janë nën kompetencat e tij sipas Statutit dhe rregulloreve të FSHF-së.
4. Komisioni i Disiplinës gjithashtu ka juridiksion në rast se një subjekt anëtar ose pjesëmarrës në aktivitetet e FSHF-së kryen shkelje serioze të objektivave statutore të FSHF-së, shkel parimin e besnikërisë ose dëmton interesat e FSHF-së.

---

**Neni 72 Komisioni i Apelit**

---

1. Komisioni i Apelit përbëhet nga një kryetar, një nënkryetar dhe tre anëtarë të tjerë.
2. Si rregull, Organi i Apelit merr vendime në prani të paktën tre anëtarëve të tij. Kryetari mund ta zgjerojë kuorumin nëse e konsideron të nevojshme.
3. Kryetari i Komisionit Apelit, ose zëvendëskryetari ose një prej anëtarëve të tij që vepron si kryetar në një rast të caktuar, mund të marrë vendim si gjyqtar i vetëm:
  - a. në raste urgjente ose protesta;
  - b. në rastet kur sanksioni i vendosur nga Komisioni i Disiplinës është një gjobë deri në 100.000 Lekë ose pezullim nga luajtja ose kryerja e një funksioni për deri në tre ndeshje;
  - c. në rastet kur kërkimet e palëve dhe inspektorit të disiplinës dhe etikës janë të njëjta dhe midis tyre nuk ka debat;
  - d. në rastet kur ankesa është qartësisht e papranueshme; ose
  - e. me kërkesë të palëve dhe inspektorit të etikës dhe disiplinës.
4. Komisioni i Apelit ka juridiksion për të shqyrtuar ankesat kundër vendimeve të Komisionit të Disiplinës dhe për të vendosur mbi rastet veçanërisht urgjente që referohen drejtpërdrejt nga Kryetari i Komisionit të Disiplinës.

---

### **Neni 73 Inspektorët e disiplinës**

---

1. Komiteti Ekzekutiv emëron numrin e nevojshëm të inspektorëve të disiplinës dhe cakton njërin prej tyre si inspektorin kryesor.
2. Inspektorët e disiplinës përfaqësojnë FSHF–në në procedurat para organeve të drejtësisë sportive.
3. Ata mundet që:
  - a. të nisin kryesisht hetime disiplinore;
  - b. të propozojnë masa disiplinore standarde që i vendosen shoqatave anëtare, klubeve dhe individëve në përputhje me Shtojcën A të këtij kodi;
  - c. të paraqesin ankesa kundër vendimeve të Komisionit të Disiplinës dhe të përfaqësojnë çështjen përpara Komisionit të Apelit;
  - d. të përfaqësojnë FSHF–në në rast se një palë paraqet një ankesë kundër një vendimi të Komisionit të Apelit përpara Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (CAS Lausanne, Zvicër), ose përpara çdo trupe tjetër ku FSHF është dakord të shqyrtohen çështjet disiplinore të zgjidhura më parë nga organet e saj të Disiplinës.
4. Komiteti Ekzekutiv i FSHF–së, Presidenti i FSHF–së, Sekretari i Përgjithshëm i FSHF–së dhe organet disiplinore mund të emërojnë inspektorë të etikës dhe disiplinës për të kryer hetime, qoftë vetëm ose në bashkëpunim me organet e tjera të FSHF–së apo organe që nuk janë të FSHF–së.
5. Parimet e përgjithshme që rregullojnë hetimet e inspektorëve të etikës dhe disiplinës janë si më poshtë:
  - a. Një inspektor i etikës dhe disiplinës mund të hetojë shkeljet e mundshme që parashikohen nga ky kod.
  - b. Në parim, kur fillohet një hetim, njoftohen palët e interesuara. Kjo nuk zbatohet kur njoftimi i tillë nuk konsiderohet i përshtatshëm për qëllimet dhe zhvillimin

- e hetimit. Hetimet e tilla kryhen me anë të pyetjeve me shkrim dhe, kur është e nevojshme me pyetjen e individëve. Gjithashtu mund të përdoren edhe procedura të tjera hetimore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në inspektimet në terren, kërkesat për dokumenta dhe marrjen e mendimeve të ekspertëve.
- c. Një inspektor i etikës dhe disiplinës mund të emërojë një anëtar të administratës së FSHF-së për të vepruar si sekretar/e.
  - d. Nëse një inspektor i etikës dhe disiplinës konstaton se janë kryer një ose më shumë shkelje që parashikohen nga ky kod, konkluzionet e inspektorit të etikës dhe disiplinës paraqiten në formën e një raporti që kërkon hapjen e procedurave.
  - e. Nëse dyshohet për shkelje të Nenit 12 të këtij kodi, subjektet anëtare ose pjesëmarrës në aktivitetet ose individët e detyruar nga rregullat dhe rregulloren e FSHF-së duhet t'i japin inspektorit të etikës dhe disiplinës informacionin, dokumentet, regjistrimet e të dhënave dhe pajisjet e ruajtjes (tekst, imazhe, zë etj.) që lidhen me shkeljen e mundshme.
  - f. Nëse një person është marrë në pyetje, intervista përgjithësisht regjistrohet ose elektronikisht ose në formë të procesverbaleve, të cilat pastaj lexohen dhe nënshkruhen nga personi i pyetur.
  - g. Një hetim mund të rihapet nëse dalin prova apo fakte të reja që nënkuptojnë se mund të jetë kryer një shkelje që parashikohet nga ky Kod.

---

#### **Neni 74 Pavarësia**

---

1. Anëtarët e organeve disiplinore dhe të etikës dhe inspektorët disiplinorë janë të pavarur dhe nuk mund të jenë pjesë e ndonjë organi ose komisioni tjetër të FSHF-së.

2. Ata nuk do të ndërmarrin ndonjë masë dhe as nuk do të ushtrojnë ndonjë ndikim në lidhje me një çështje ku ekziston ose mendohet të ekzistojë një konflikt interesi. Në procedurat e dopingut në lidhje me individët dhe para dëgjimit, anëtarët e organeve disiplinore të FSHF-së duhet të nënshkruajnë një deklaratë zyrtare të ndërmarrjes për të ushtruar funksionet e tyre në kushtet e shprehura më lart.
3. Ata janë të detyruar ekskluzivisht nga Statuti, rregullat dhe rregulloret e FSHF-së dhe ligji.

---

#### **Neni 75 Përjashtimi i një anëtari nga procedurat**

---

1. Anëtarët e organeve disiplinore dhe të etikës dhe inspektorët disiplinorë duhet të refuzojnë të marrin pjesë në rastet që lidhen drejtpërdrejt me ata vete, ose me subjekte të tjera të lidhura me ta, ose me të cilët mund të jenë në konflikt interesi.
2. Në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje, kryetari përkatës i organit disiplinor, ose i emëruari i tij vendos për pjesëmarrjen e personit në fjalë.

---

#### **Neni 76 Vendimmarrja e shumicës**

---

1. Organet disiplinore vendosin në bazë të shumicës pa u lejuar abstenimi. Në rast të barazimit, kryetari i organit disiplinor përkatës ka votën vendimtare.
2. Anëtarët e organeve disiplinore janë të detyruar të ruajnë sekretin.

---

#### **Neni 77 Sekretariati i Komisioneve**

---

1. Administrata e FSHF-së vendos një zyrë dhe personelin e nevojshëm në dispozicion të organeve disiplinore dhe inspektorëve të etikës dhe disiplinës në selinë e FSHF-së.



2. Sekretariati është përgjegjës për detyrat administrative, për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve dhe për përgatitjen e drafteve të vendimeve që duhet të merren nga organet disiplinore.

---

### **Neni 78 Përgjegjësitë**

---

Anëtarët e organeve disiplinore, inspektorët e etikës dhe disiplinës dhe stafi i sekretariatit nuk janë përgjegjës për ndonjë veprim apo mosveprim në lidhje me procedurat disiplinore, me përjashtim për rastet e neglizhencës së rëndë apo qëllimit të paligjshëm.

### **SEKSIONI 3:**

Dispozita të përbashkëta për procedurat para organeve disiplinore

---

### **Neni 79 Palët dhe ndërhyrësit**

---

1. Palët përbëhen nga:
  - a. subjektet anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitet ose individët e detyruar nga që është prekur drejtpërdrejt;
  - b. individi/organi, i cili ka të drejtë të ankohet dhe kundërshtari në atë ankesë.
2. subjektet anëtare ose pjesëmarrës në aktivitet ose individët /organet e tjera që mund të preken drejtpërsëdrejti nga procedurat mund të ftohen nga organi përkatës disiplinor për të marrë pjesë në procedurë si ndërhyrës, me iniciativë të organit kompetent disiplinor ose me kërkesë të subjekteve anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitet ose individët pjesëmarrës ne procedura.

---

## **Neni 80 Përfaqësimi**

---

1. Subjektet anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitet ose individët mund të zgjidhin përfaqësues në këto procedura
2. Përfaqësuesit duhet të dëshmojnë autoritetin e tyre me anë të një prokure ose autorizim të nënshkruar nga i përfaqësuari.
3. Organi kompetent disiplinor vendos për çështjet e përfaqësimit.

---

## **Neni 81 Ndhimja juridike**

---

1. Për të garantuar të drejtat e tyre, individët e lidhur me këto rregulla dhe me mjete financiare të pamjaftueshme mund të kërkojnë ndihmë juridike nga FSHF për qëllimet e procedurave para organeve disiplinore të FSHF.
2. Aplikantët për ndihmë juridike duhet të paraqesin kërkesa të arsyetuara dhe dokumente mbështetëse.
3. Administrata e FSHF-së vendos për kërkesat për ndihmë juridike. Vendime të tilla janë përfundimtare.
4. Kushtet dhe kërkesat e mëtejshme që lidhen me ndihmën juridike vendosen nga Komiteti Ekzekutiv.

---

## **Neni 82 Gjuhët**

---

1. Procedurat disiplinore, të shkruara dhe të folura, zhvillohen në gjuhën Shqipe.
2. Çdo palë që dëshiron të përdorë një gjuhë tjetër në seancë duhet të kërkojë në kohën e duhur shërbimet e një përkthyesi, për shpenzimet e të cilit duhet të kujdeset fillimisht ai që e ka kërkuar.

---

**Neni 83 Mbledhjet, të drejtat e palëve, seancat, vendimet, komunikimet dhe konfidencialiteti.**

---

1. Organet disiplinore thirren nga kryetarët e tyre përkatës.
2. Përveç kur parashikohet ndryshe, palët dhe inspektorët e etikës dhe disiplinës kanë të drejtë të paraqesin deklarata me shkrim, të shqyrtojnë dosjen e çështjes dhe të kërkojnë kopjet e dosjes së çështjes para se të arrihet ndonjë vendim.
3. Seancat dëgjimore regjistrohen dhe arkivohen. Palët nuk kanë akses në regjistrimet e seancave dëgjimore; megjithatë, nëse një palë pretendon se rregullat procedurale në favor të saj janë shkelur gjatë seancës dëgjimore, kryetari i organit kompetent disiplinor ose i emëruari i tij mund ta lejojë atë palë të dëgjojë dhe/ose shikojë regjistrimin në selinë e FSHF-së. Regjistrimet shkatërrohen pas pesë vjetësh.
4. Organet disiplinore mund të mbajnë seanca dëgjimore dhe të marrin vendime në mungesë të njëjës ose të gjitha palëve dhe/ose inspektorit të etikës dhe disiplinës.
5. Nëse kërkesat e palëve, të etikës dhe të inspektorit disiplinor janë identike, organet disiplinore mund të shqyrtojnë vendimin në pajtim me ato kërkesa.
6. Nëse janë hapur procedura të ndryshme kundër të njëjtës shoqatë anëtare, klubi ose individi, organi kompetent disiplinor mund të bashkojë procedimet/rastet dhe të nxjerrë një vendim gjithëpërfshirës për to.
7. Seancat dëgjimore të organeve disiplinore të FSHF-së nuk janë të hapura për publikun, përveç rasteve të shkeljeve të rregullave anti-doping nga individët nëse kërkohet siç duhet nga i proceduari dhe kur është miratuar nga kryetari i organit përkatës disiplinor. Kryetari vendos sipas gjykimit të tij nëse dhe në çfarë kushtesh mund të zhvillohet seanca publike.

8. Organet disiplinore mund të marrin vendime nëpërmjet telekonferencës, video – konferencës ose ndonjë metode tjetër të ngjashme.
9. Të gjitha komunikimet në lidhje me një subjekt anëtarë ose pjesëmarrës në aktivitet ose individët (duke përfshirë njoftimin e procedurave kundër tyre dhe nxjerrjen e vendimeve të marra nga organet disiplinore) i njoftohen subjektit anëtarë ose pjesëmarrës në aktivitet, i cili më tej, duhet ta njoftojë individin personalisht. Të gjitha këto komunikime nga FSHF ose organet disiplinore mund të jenë në formën e fakseve ose postës elektronike të dërguar nga sekretariati i komisioneve të FSHF-së.
10. Të gjitha letrat dhe dokumentet e hartuara gjatë procedurave disiplinore që nuk janë në dispozicion të publikut duhet të mbahen konfidenciale.
11. Organi kompetent disiplinor mund të korrigjojë çdo gabim në llogaritje ose çdo gabim tjetër të qartë në vendim në çdo kohë.

---

## **Neni 84 Afatet**

---

1. Çdo afat fillon të nesërmen e ditës pas së cilës njoftohet akti ose ngjarja. Afati konsiderohet se është respektuar nëse veprohet brenda orës 24.00 (Ora Qëndrore Evropiane) të ditës së fundit të afatit. Festat zyrtare dhe ditët e pushimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë përfshihen në llogaritjen e afateve kohore. Afatet pezullohen nga 20 Dhjetori deri në 5 Janar.
2. Kur afati përfundon të dielën ose në një festë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, ai do të shtyhet deri në ditën e ardhshme të punës.
3. Nëse nuk respektohet një afat kohor, pala që ka humbur afatin, humbet të drejtën procedurale në fjalë.

4. Afatet kohore të përcaktuara me këto rregullore nuk mund të zgjaten ose të rivendosen.

---

#### **Neni 85 Ndëshkimet e sjelljes jo të rregullt**

---

1. Çdo pjesëmarrës në procedim, sjellja e të cilit shkel rregullin e procedimeve mund të qortohet, gjobitet deri në 50.000 Lekë ose të përjashtohet nga seanca dëgjimore me vendim të kryetarit.
2. Ndëshkimet e sjelljes së parregullt (dmth. ndëshkimet për mungesë respekti/shpërfillje) zbatohen ekskluzivisht për individët dhe janë të pa apelueshme. Me përjashtim të vërejtjeve, dënimet e tilla duhet të regjistrohen, me arsyet e theksuara në vendimin përkatës.

---

#### **Neni 86 Format e provës**

---

1. Çdo lloj prove mund të përdoret gjatë hetimeve disiplinore dhe procedurave, me kusht që dinjiteti njerëzor të mos shkelet. Format e vlefshme të provave në hetimet dhe procedurat disiplinore përfshijnë raportet dhe regjistrimet zyrtare, pyetjen e dëshmitarëve, pyetjen e palëve dhe inspektoreve të etikës dhe disiplinës, inspektimet në vend, mendimet e ekspertëve, regjistrimet televizive dhe video, pohimet personale dhe regjistrimet e çdo dokumente tjetër.
2. Organet disiplinore mund të kërkojnë prova të mëtejshme në çdo kohë.

---

#### **Neni 87 Raportet zyrtare**

---

Faktet e përfshira në raportet zyrtare të FSHF-së prezumohen të jenë të sakta dhe të vërteta. Megjithatë mund të provohet e kundërta në lidhje me saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

---

**Neni 88 Dëshmitarët**

---

1. Të gjithë personat nën juridiksionin e FSHF-së janë të detyruar t'i binden një thirrje për t'u paraqitur si dëshmitar përpara trupave disiplinore. Çdokush që nuk vepron në pajtim me thirrjet mund të sanksionohet në përputhje me këtë kod. Organet disiplinore mund të marrin në konsideratën e duhur çdo refuzim të pajustificuar për tu paraqitur në seancë dhe/ose për të dhënë dëshmi nga pala, përfaqësuesi i një pale ose nga një dëshmitar.
2. Të gjithë personat e thirrur për të dëshmuar para organeve disiplinore janë të detyruar të tregojnë të vërtetën dhe t'i përgjigjen me ndërgjegje të pastër çdo pyetjeje që u kërkohet.
3. Kryetari i organit kompetent disiplinor vendos për pyetjen e dëshmitarëve të propozuar nga palët dhe inspektori i etikës dhe disiplinës. Secila palë është përgjegjëse për sigurimin e disponueshmërisë dhe mbulimin e shpenzimeve të dëshmitarëve që thërret për dëshmi.
4. Organet disiplinore mund të kufizojnë ose refuzojnë dëshminë e ndonjë dëshmitari, apo ndonjë pjese të tij, për shkak të mungesës së lidhjes së dëshmisë me çështjen.

---

**Neni 89 Dëshmitarët anonimë**

---

1. Kur dëshmia e një personi në procedurat disiplinore të hapura në përputhje me këto rregullore mund të rrezikojë jetën e tij ose ta vendosë atë person ose familjen e tij ose miqtë e ngushtë në rrezik fizik, kryetari i organit disiplinor kompetent ose i emëruari prej tij mund të urdhërojë që:
  - a. dëshmitari mos të identifikohet në praninë e palëve dhe inspektorit të etikës dhe disiplinës;
  - b. dëshmitari mos të paraqitet në seancë;
  - c. të gjitha ose disa nga informacionet që mund të përdoren për të identifikuar dëshmitarin, duhet të përfshihen vetëm në një dosje të veçantë dhe konfidenciale.

2. Duke pasur parasysh rrethanat e përgjithshme (veçanërisht nëse nuk ka dëshmi të tjera për të vërtetuar atë të dëshmitarit anonim) dhe nëse është teknikisht e mundur, kryetari i organit disiplinor kompetent ose i emëruari i tij, ose me kërkesë të njëjës prej palëve ose të inspektorit të etikës dhe disiplinës mundet që:
  - a. zëri i dëshmitarit të shtrembërohet;
  - b. fytyra e dëshmitarit të maskohet;
  - c. dëshmitari mund të merret në pyetje jashtë sallës së gjykatës;
  - d. dëshmitari merret në pyetje me shkrim nëpërmjet kryetarit të organit disiplinor kompetent ose të propozuarit të tij.
3. Masat disiplinore vendosen ndaj kujtdo që zbulon identitetin e një dëshmitari anonim ose ndonjë informacion që mund të përdoret për ta identifikuar atë.

---

#### **Neni 90 Identifikimi i dëshmitarëve anonim**

---

1. Për të garantuar sigurinë e tyre, dëshmitarët anonimë identifikohen pas dyerve të mbyllura në mungesë të palëve dhe inspektorit të etikës dhe disiplinës. Kjo kryhet nga kryetari i organit kompetent disiplinor, ose i emëruari i tij, i vetëm ose nga të gjithë anëtarët e organit kompetent disiplinor, dhe regjistrohet në procesverbalin që përmban të dhënat personale të dëshmitarit.
2. Këto minuta nuk u komunikohen palëve dhe inspektorit të etikës dhe disiplinës.
3. Palët dhe inspektori i etikës dhe disiplinës marrin një shënim të shkurtër që:
  - a. konfirmon se dëshmitari anonim është identifikuar zyrtarisht; dhe
  - b. nuk përmban detaje që mund të përdoren për të identifikuar dëshmitarin anonim.

---

### **Neni 91 Masat e përkohshme**

---

1. Kryetari i organit kompetent disiplinor ka të drejtë të marrë masa të përkohshme kur ato konsiderohen të nevojshme për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë, për të ruajtur disiplinën sportive ose për të shmangur dëmtime të pariparueshme të provave. Ai nuk është i detyruar të dëgjojë palët dhe/ose inspektorin e etikës dhe disiplinës.
2. Një masë e përkohshme mund të jetë me efekt deri në 90 ditë. Kohëzgjatja e çdo mase të tillë mund të zbritet nga sanksioni disiplinor përfundimtar. Kryetari i organit kompetent disiplinor, mund të zgjasë në mënyrë të veçantë vlefshmërinë e masës së përkohshme deri në 30 ditë.
3. Masat e përkohshme të shpallura nga kryetari i Komisionit të Disiplinës, ose i emëruari i tij mund të apeloher në përputhje me dispozitat përkatëse të këtyre rregulloreve. Megjithatë, ankesa duhet të mbërrijë në FSHF me shkrim dhe me arsyetim brenda tre ditëve nga njoftimi i masës së kontestuar dhe për ankimin nuk ka asnjë pagesë. Kryetari i Komisionit të Apelit, ose i emëruari i tij, vendos për ankesat e tilla si gjykatës i vetëm. Vendime të tilla janë përfundimtare.

---

### **Neni 92 Apeli i vendimeve për çështjet paraprake**

---

Vendimet për çështjet paraprake mund të apeloher veçmas vetëm nëse ato mund të shkaktojnë dëm të pariparueshëm për një palë të caktuar ose FSHF-në.

---

### **Neni 93 Shpenzimet proceduriale**

---

1. Kostot e procedurave para Organeve Juridike mbulohen nga FSHF, me përjashtim të rasteve të ankesave, kur ato përballohen nga pala përkatëse.



2. Shpërndarja e kostove të procedurës pranë Organit të Apelit varet nga rezultati i këtyre procedurave, me përjashtim të rasteve të procedurave disiplinore të hapura ndaj individëve të akuzuar për shkelje të rregullit anti-doping, të cilat nuk kanë shpenzime. Për pjesën tjetër, Organi i Apelit vendos sipas gjykimit të tij se si shpenzimet e procedurave do t'u shpërndahen palëve të ndryshme ose nëse do të përballohen nga FSHF. Ankesat kundër vendimeve të tilla nuk janë të pranueshme. Tarifa e ankimit ose zbritet nga shpenzimet e procedurës ose rimbursohet.
3. Kostot e shkaktuara në mënyrë abuzive nga një palë i ngarkohen palës përgjegjëse, pavarësisht nga rezultati i procedurës.
4. Secila palë mban kostot e veta, duke përfshirë kostot e dëshmitarëve të vet, përfaqësuesve, këshilltarëve ligjorë dhe avokatëve.

---

#### **Neni 94 Vendimet**

---

1. Në parim, organet disiplinore lëshojnë vendime pa arsyetim, dhe palëve u njoftohet vetëm pjesa dispozitive e vendimit, të cilët kanë pesë ditë kohë nga ky njoftim për të kërkuar me shkrim vendimin e arsytuar. Në rast se palët nuk bëjnë një kërkesë të tillë, kjo e bën vendimin përfundimtar e detyrues dhe palët konsiderohen se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për të paraqitur ankim.
2. Nëse një vendim me arsyetim kërkohet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më sipër, afati kohor për paraqitjen e ankesës fillon vetëm pas njoftimit të arsytimit. Vetëm palët në të cilat është adresuar një vendim dhe inspektori i disiplinës mund të kërkojnë vendim të arsytuar.
3. Çdo ankesë e paraqitur para njoftimit të arsytimit konsiderohet ekskluzivisht si një kërkesë për një vendim të arsytuar.
4. Vendimet e lidhura me Doping shpallen gjithnjë me arsyetim.

5. Administrata e FSHF-së publikon vendimet e nxjerra nga organet disiplinore. Kur një vendim i tillë përmban informacion konfidencial, administrata e FSHF-së mund të vendosë, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të njëjës nga palët, ose inspektorit të disiplinës, të publikojë një version anonim.

---

#### **Neni 95 Rihapja e procedurave**

---

1. Sipas kërkesës, organi kompetent disiplinor rihap procedurat kur një palë ose FSHF pretendon të ketë fakte dhe prova të reja dhe thelbësore që nuk ishte në gjendje ti paraqiste më parë se vendimi të bëhej i ekzekutueshëm
2. Një kërkesë për rihapjen e procedurës duhet t'i drejtohet organit disiplinor që ka marrë vendimin e kontestuar brenda 14 ditëve nga momenti kur është bërë i ditur shkaku i rihapjes, dhe jo më shumë se katër vjet pasi vendimi në fjalë të jetë bërë i ekzekutueshëm.
3. Rastet që lidhen me doping ose shkeljet e manipulimit të ndeshjeve nuk i nënshtrohen kufizimeve të mësipërme dhe mund të rihapen në çdo kohë.

---

#### **Neni 96 Gjykata e Arbitrazhit të Sportit**

---

Për sa është e lejuar në këtë Kod, në Statutin e FSHF, UEFA apo FIFA dhe në rregullat e Gjykatës sv Arbitrazhit tv Sportiti (TAS/CAS Lozane), nëse nuk parashikohet mundësi tjetër ankimi nga rregulloret e FSHF, vendimet e organeve të drejtësisë të treguara në këtë kod mund të apelojnë në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (TAS/CAS Lozane).

## Kreu II – Procedurat para Komisionit të Disiplinës

---

### Neni 97 Hapja e procedurave

---

1. Procedurat disiplinore hapen nga administrata e FSHF-së:
  - a. në bazë të raporteve zyrtare;
  - b. kur është paraqitur një ankesë;
  - c. me kërkesë të Komitetit Ekzekutiv të FSHF-së, Presidentit të FSHF-së ose Sekretarit të Përgjithshëm të FSHF-së;
  - d. me kërkesë të një inspektori të disiplinës;
  - e. në bazë të dokumenteve të marra nga një autoritet publik;
  - f. kur është parashtruar ankesë, me miratimin paraprak të një inspektori të disiplinës sipas paragrafit 2 më poshtë.
2. Në rastin kur është paraqitur një ankesë, një inspektor i disiplinës duhet të vlerësojë një ankesë të tillë. Në diskrecionin e tij, inspektori i disiplinës mund të vendosë të mos miratojë hapjen e procedurës nëse nuk ka arsye të vlefshme për ta bërë këtë. Një mungesë e tillë e arsyeve të vlefshme ndodh, për shembull, kur çështja në fjalë mund të ketë qenë subjekt i një ankese ose kur pala që paraqet ankesën nuk ka interes ligjor të denjë për mbrojtje.
3. Një vendim i inspektorëve të disiplinës për të mos aprovuar hapjen e procedurës mund të apelohej para Komisionit të Disiplinës brenda pesë ditëve pas njoftimit të vendimit.

---

### Neni 98 Deklaratat e protestës/ankesës

---

1. Subjekti anëtar ose pjesëmarrës në aktivitet si edhe individët kanë të drejtë të bëjnë ankesa. Ankesat duhet të paraqiten me shkrim në Komisionin e Disiplinës, duke treguar arsyet përkatëse, brenda 24 orëve nga përfundimi i ndeshjes në fjalë.

2. Afati prej 24 orësh nuk mund të zgjatet. Për hir të zhvillimit normal të ndeshjes, rregulloret përkatëse të ndeshjeve mund të shkurtojnë afatin e ankesës në përputhje me rrethanat.
3. Tarifa e ankesës është 10.000 Lekë. Ajo duhet të paguhet me paraqitjen e ankesës dhe të rimburohet vetëm nëse ankesa pranohet.

---

### **Neni 99 Pranimi i deklaratave të protestës/ankesave**

---

1. Ankesa është e pranueshme vetëm nëse mbështetet në:
  - a. një pjesëmarrje të lojtarit të papërzgjedhur në një ndeshje e si pasojë atij lojtari nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në rregulloret përkatëse të konkurrencës;
  - b. një gabim i dukshëm nga arbitri siç përcaktohet në Nenin 9 të këtyre rregulloreve, rast në të cilin ankesa mund të drejtohet vetëm në pasojat disiplinore të gabimit të dukshëm të gjyqtarit;
  - c. një shkelje e qartë e një rregulli nga arbitri që ka pasur një ndikim vendimtar në rezultatin përfundimtar të ndeshjes;
  - d. çdo incident tjetër i rëndësishëm që ka pasur një ndikim vendimtar në rezultatin përfundimtar të ndeshjes.
2. Ankesat nuk mund të paraqiten kundër vendimeve të marra nga gjyqtari në lidhje me faktet.

---

### **Neni 100 Sqarimi i fakteve**

---

Si rregull, Komisioni i Disiplinës sqaron faktet e rastit në mënyrë të përmbledhur, në bazë të raporteve zyrtare. Ai shqyrton çdo dokument tjetër përkatës në posedim të tij dhe mund të mbledhë prova të tjera, me kusht që kjo të mos e shtyjë procedurën në mënyrë të padrejtë.

---

### Neni 101 Forma e procedurave

---

Në parim, procedurat para Komisionit të Disiplinës kryhen me shkrim.

### SEKSIONI 4:

Procedurat para Komisionit të Apelit

---

### Neni 102 Apelet, afatet dhe tarifaf

---

1. Palët që preken direkt nga një vendim dhe inspektori i disiplinës kanë të drejtë të ankohen.
2. Një ankim kundër një vendimi të Komisionit të Disiplinës duhet të depozitohet në administratën e FSHF-së, me shkrim, drejtuar Komisionit të Apelit, brenda tre ditëve nga lëshimi i vendimit përkatës me arsyetimin përkatës. Rregullat e aktivitetit, megjithatë, mund të shkurtojnë këtë afat për hir të zhvillimit normal të aktivitetit në fjalë.
3. Brenda pesë ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e ankimit, ankuesi duhet të paraqesë me shkrim arsyet për ankimin. Këto duhet të përmbajnë shkaqet ligjore, një përmbledhje të fakteve, provat, një listë të dëshmitarëve të propozuar për tu dëgjuar (me një përmbledhje të shkurtër të dëshmisë së tyre të pritur) dhe qëndrimin e ankuesit në veçanti nëse duhet të zhvillohet procedura e apelit me gojë ose me shkrim. Në mungesë të qëndrimit lidhur me zhvillimin e procedurave me shkrim apo me gojë, procedimet do të kryhen me shkrim. Palët dhe inspektori i disiplinës nuk janë të autorizuar të paraqesin parashtresa ose prova të mëtejshme me shkrim pas afatit të fundit për paraqitjen e arsyeve për ankimin. Në raste urgjente, kryetari mund ta shkurtojë afatin.
4. Tarifa e apelit është 100.000 Lekë, që duhet të paguhet brenda afatit të fundit për paraqitjen e arsyeve të ankimit. Sidoqoftë, pagesa për ankimin nuk aplikohet për ankime kundër vendimeve

për shkeljet e rregullave antidoping nga individët dhe për kërkesat ankimore e paraqitura nga inspektori i etikës dhe disiplinës.

5. Nëse këto afate nuk respektohen, kryetari e deklaron ankimin si të papranueshëm.

---

### **Neni 103 Pranimi i Ankimeve**

---

1. Ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Disiplinës janë të pranueshme, përveç rastit kur masa disiplinore e vendosur në shkallën e parë është kufizuar në:
  - a. një paralajmërim;
  - b. një qortim;
  - c. një pezullim automatik me një ndeshje pas largimit nga fusha.
2. Asnjë ankim nuk është i pranueshëm nëse një palë nuk kërkon, në kohën e duhur, nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar, në përputhje me Nenin 52 të këtij Kodi.

---

### **Neni 104 Pezullimi i ekzekutimit**

---

1. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimeve.
2. Kryetari, me marrjen e një kërkesë të arsyetuar, mund të vendosi për një pezullim të përkohshëm të ekzekutimit.

---

### **Neni 105 Përgjigja ndaj Ankimit**

---

1. Kryetari njofton inspektorin e disiplinës dhe/ose palët e interesuara për Ankimin. Përgjigja me shkrim ndaj Ankimit duhet të paraqitet brenda afatit të caktuar nga kryetari.
2. Inspektori i disiplinës duhet detyrimisht të përgjigjet ndaj ankimit me shkrim në rast se pretendohen shkeljet e Nenit 12, 13 ose

14. Në rastin e ndonjë shkelje tjetër të dyshuar disiplinore, ai duhet t'i përgjigjet ankesës vetëm nëse vendoset nga inspektori kryesor i etikës dhe disiplinës në diskrecionin e tij.

---

### **Neni 106 Seancat dëgjimore**

---

1. Procedura para Komisionit të Apelit kryhet me gojë ose me shkrim.
2. Kur kërkohet nga një palë ose inspektori disiplinës, ose kur kryetari i komisionit të apelit e konsideron të nevojshme, kryetari cakton datën e seancës dhe thërret palët, dhe inspektorin e disiplinës.
3. Nëse zhvillohet një seancë dëgjimore, palët dhe inspektori i disiplinës kanë të drejtë për dy debate me gojë. Kryetari vendos për rendin e debateve. Nëse i pari që deklaron heq dorë nga e drejta e tij për të kërkuar për herë të dytë, procesi i pranimit përfundon.

---

### **Neni 107 Shqyrtimet dhe vendimet**

---

1. Komisioni i Apelit diskuton vendimmarrjen me dyer të mbyllura.
2. Brenda kuadrit të procedurës së apelit, Komisioni i Apelit ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar faktet dhe ligjin.
3. Vendimi i Komisionit të Apelit lë në fuqi, ndryshon ose shfuqizon vendimin e objekt ankimit.
4. Nëse i akuzuari është e vetmja palë që ka paraqitur ankesë, sanksioni nuk mund të rritet.
5. Nëse dalin në dritë shkelje të reja disiplinore, ndërkohë që procedurat e apelit janë në pritje, ato mund të gjykojnë gjatë të njëjtit procedim. Në një situatë të tillë, sanksioni mund të rritet.
6. Vendimet e Organit të Apelit janë përfundimtare, në përputhje me Nenet 42 të Statutit të FSHF-së.

## KREU III

---

### Neni 108 Rishikimi i Vendimeve

---

1. Pas marrjes dhe hyrjes në fuqi të një vendimi përfundimtar, nëse një palë zbulon fakte ose prova, të cilat do të rezultojnë në marrjen e një vendimi më të favorshëm, kjo palë ka të drejtë të kërkojë rishikimin e vendimit përkatës.
2. Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zbulimi i arsyeve për rishikim.
3. Periudha e parashkrimit për të paraqitur një kërkesë për rishikim të vendimit është një vit nga hyrja në fuqi e vendimit përkatës



## TITULLI IV – DISPOZITA TË VEÇANTA

### SEKSIONI 1:

Zbatimi/Ekzekutimi

---

#### Neni 109 Kompetenca

---

1. Administrata e FSHF-së ka kompetencën për të zbatuar vendimet e organeve disiplinore. Ajo mund të urdhërojë subjektin anëtar ose pjesëmarrës në aktivitet si edhe individë të interesuar që të zbatojë një vendim.
2. Si garanci për zbatimin, subjektet anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitet janë të përgjegjshme bashkërisht dhe individualisht për gjokat, konfiskimin e përfitimeve në para dhe kostot procedurale të vendosura në klubet, lojtarët, zyrtarët ose anëtarët e tyre; klubet mbajnë të njëjtën përgjegjësi në lidhje me lojtarët, zyrtarët dhe anëtarët e tyre.
3. Organet disiplinore, në rast se vlerësojnë se ka vend për të ndryshuar mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të tyre të parashikuar në këtë titull, ato vendosin për mënyrën e ekzekutimit në dispozitivin e vendimit.

---

#### Neni 110 Dëbimi dhe vërejtjet e grumbulluara

---

1. Me përjashtim të rasteve kur organi kompetent disiplinor vendos ndryshe, një lojtar që largohet nga fusha e lojës ose një zyrtar i dëbuar nga zona teknike pezullohet automatikisht për ndeshjen tjetër të aktivitetit në të cilin ka ndodhur dëbimi.

2. Një lojtar apo një zyrtar i ekipit, i cili merr paralajmërimet (karton i verdhë) në ndeshjet e ndryshme të të njëjtit aktiviteti pezullohet për ndeshjen tjetër të po atij aktiviteti, në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregulloret e aktivitetit në fjalë dhe çdo direktivë të botuar. Pezullimet e tilla duhet të zbatohen para çdo pezullimi tjetër.
3. Nëse një ndeshje përsëritet në mënyrë të plotë, çdo paralajmërim (karton i verdhë) i dhënë në këtë ndeshje duhet të anulohet.
4. Paralajmërimet e dhëna në një ndeshje që më pas shpallet e humbur në tavolinë nuk do të anulohen.

---

### **Neni 111 Zbatueshmëria**

---

1. Masat disiplinore dhe direktivat hyjnë në fuqi në momentin që njoftohen, me përjashtim të:
  - a. pezullimeve automatike pas disa kartonave të verdhë ose një karton i vetëm i kuq, kur nuk ka asnjë rast për zgjatjen e pezullimit; pezullime të tilla janë të zbatueshme menjëherë dhe nuk kërkohet asnjë njoftim;
  - b. masat disiplinore të një natyre financiare, të cilat janë të zbatueshme brenda 30 ditëve nga njoftimi i tyre, përveç rastit kur organi kompetent disiplinor vendos ndryshe.

---

### **Neni 112 Zbatimi i jashtëzakonshëm i pezullimeve**

---

Një pezullim i ndeshjes konsiderohet se nuk është më në pritje për të rinisur, nëse ndeshja është:

- a. deklaruar në mënyrë retroaktive e humbur në tavolinë;
- b. braktisur para përfundimit dhe nuk është përsëritur më.

---

**Neni 113 Afatet kohore për ekzekutimin e vendimeve**


---

1. Zbatimi i vendimeve nuk kryhet më:
  - a. për përjashtimet nga garat e FSHF-s:
    - i. pas pesë viteve për përjashtimet për një sezon
    - ii. pas tetë viteve për përjashtimet për dy sezone;
    - iii. pas dhjetë viteve për përjashtimet në tejkallim të dy sezoneve;
  - b. për mbylljet e stadiumeve dhe ndeshjet që do të luhen pas dyerve të mbyllura:
    - i. pas pesë vitesh për masat që aplikohen për një ose dy ndeshje,
    - ii. pas tetë vitesh për masat që aplikohen për tre ose katër ndeshje,
    - iii. pas dhjetë vitesh për masat që aplikohen për më shumë se katër ndeshje;
  - c. për pezullimin e individëve:
    - i. pas dy vitesh për pezullime për një ose dy ndeshje,
    - ii. pas pesë vitesh për pezullime për tre deri në gjashtë ndeshje,
    - iii. pas tetë vjetësh për pezullime që tejkalojnë gjashtë ndeshje;
  - d. pas pesë vitesh për të gjitha masat e tjera disiplinore.
  
2. Shkeljet që përfshijnë manipulimin e ndeshjeve, ryshfetin dhe korrupsionin nuk u nënshtrohen këtyre afateve kohore.  
 Afati i zbatimit fillon më 1 Gusht pas sezonit në të cilin është vendosur masa disiplinore. Afati kohor përmban një numër të caktuar të viteve të llogaritur sipas sezonit të FSHF-së, dmth. nga 1 Gushti i një viti deri më 31 Korrik të vitit të ardhshëm.

## TITULLI V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

---

### Neni 114 Qëllimi i kodit, mangësitë, dhe precedentët

---

1. Ky kod është i zbatueshëm nga çdo subjekt që përshkruhet në përcaktimet e këtij kod.
2. Nëse ka ndonjë mangësi në këtë kod, organet juridike do të marrin vendimet në përputhje me precedentët e krijuar më parë, dhe në mungesë të precedentëve, në përputhje me rregullat që ata mund të formulonin për çështjen në fjalë sikur të ishin legjislatorë.

---

### Neni 115 Konvertimi i dënimeve

---

1. Dënimet në vijim:
  - a) pezullim nga ndeshja;
  - b) zhvillim i ndeshjes pa spektatorë; dhe
  - c) zhvillim i ndeshjes në fushë asnjëse; mund të konvertohen në dënime me gjobë.
2. Pezullimi nga ndeshja i lojtarëve ose zyrtarëve për më shumë se 1 ndeshje mund të konvertohet pasi të jetë shlyer gjysma e dënimit.
3. Dënimet e përcaktuara këtu më sipër në paragrafin 1 të këtij neni konvertohen si më poshtë:
  - a) zhvillimi i ndeshjes pa spektatorë do të konvertohet me gjobë me vlerë prej 500,000 (pesëqind mijë) Lekë, për çdo ndeshje vetëm pasi të jetë kryer gjysma e dënimit;

- b) zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjëherë do të konvertohet me gjobë me vlerë prej 600,000 (gjashtëqind mijë) Lekë, për çdo ndeshje vetëm pasi të jetë kryer gjysma e dënimit;
  - c) Pezullimi nga ndeshja i lojtarëve ose zyrtarëve do të konvertohet me gjobë si në vijim pasi të jetë kryer gjysma e dënimit:
    - i. Pas kryerjes së gjysmës së dënimit të pezullimit, dënimi mund të konvertohet me gjobë me vlerë prej 100.000 lekësh për çdo ndeshje.
4. Konvertimi i dënimeve do të kryhet për të gjitha ndeshjet e mbetura nga dënimi në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të këtij neni. Nuk mund të konvertohen dënimet me mbi 10 ndeshje pezullim nga aktiviteti, dënimet e dhëna mbi shkeljet e Statusit të Lojtarit apo dënimet e dhëna nga Komisioni i Etikës.
5. Kur lojtari ose zyrtari i cili aktivizohet në një ndeshje duke zbatuar përcaktimet në këtë nen, dënimet gjatë zhvillimit të ndeshjes përkatëse, dënimet e marra do t'i mbliidhen dënimeve ekzistuese.

---

#### **Neni 116 Reduktimi i dënimeve me gjobë**

---

1. Për Veprimtaritë futbollistike të niveleve më të ulëta se Kampionati Kombëtar i Kategorisë Superiore dënimet me gjoba të aplikohen në masën si më poshtë:
- a) Për Kampionatin Kombëtar
 

të Kategorisë së Parë:	50 %
------------------------	------
  - b) Për Kampionatin Kombëtar
 

të Kategorisë së Dytë:	20 %
------------------------	------
  - c) Për Kampionatin Kombëtar
 

të Kategorisë së Tretë:	10 %
-------------------------	------

d) Për veprimtaritë e futbollit të femrave:	5 %
e) Për veprimtaritë e futbollit për të rinj:	3 %
f) Për veprimtaritë e futbollit 5x5:	20 %

---

**Neni 117 Zbatimi i kodit**

---

1. Ky kod hyn në fuqi më datë 01.08.2019

**Armand Duka**

President

**Ilir Shulku**

Sekretar i Përgjithshëm



